



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
“MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË”
NË
AUTORITETIN E KONKURRENCËS

TIRANË, qershor 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve	4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	5
II.	HYRJA	6
1.	Objektivat dhe qëllimi	6
2.	Identifikimi i çështjes	7
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
4.	Përgjegjësitë e audituesve	7
5.	Kriteret e vlerësimit	8
6.	Standartet e auditimit	8
7.	Metodat e auditimit	8
8.	Dokumentimi i auditimit	9
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	10
III.1.	Informacion i përgjithshëm	10
III.2.1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të Autoritetit të Konkurrencës	10
III.2.2	Veprimtaria e institucionit mbi monitorimin e tregjeve dhe procedurave të tjera për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2023 “ <i>Për mbrojtjen e Konkurrencës</i> ”, i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore rregulluese.	20
III.2.3	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar	24
III.2.4	Të tjera	34
IV.	REKOMANDIME	46

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Autoriteti i Konkurrencës është organ publik, i pavarur. Buxheti vjetor për financimin e veprimtarisë së Autoritetit, i cili përbën zë me vete në Buxhetin e Shtetit, miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë. Të ardhurat që krijohen në zbatim të këtij ligji, përfshirë edhe të ardhurat nga gjobat, derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe përdoren sipas akteve ligjore në fuqi. Autoriteti mban llogari të shpenzimeve dhe të të ardhurave faktike.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Auditimi i këtij subjekti është auditim përputhshmërie, sipas planit vjetor të miratuar për vitin 2025, nga Kryetari i Kontrollit të lartë të Shtetit dhe në vijim të rëndësisë që ka kontrolli i sjelljes së operatorëve privat në ekonominë shqiptare, referuar kompetencave të Autoritetit të Konkurrencës për monitorimin dhe marrjen e masave për eliminimin e konkurrencës së pandershme.

Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për çështje të ndjekjes së masave administrative të aplikuara për korrigjimin e sjelljes së operatorëve privatë në ekonominë shqiptare.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën objekt auditimi sipas pikave të programit. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjektet e audituara. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

1. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të Autoritetit të Konkurrencës.
2. Veprimtaria e institucionit mbi monitorimin e tregjeve dhe procedurave të tjera për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe akteve të tjera nënligjore rregulluese.
3. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.
4. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme: Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse: Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/informacioneve relevante dhe të tjera që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimet e auditimit; Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 6 gjetje dhe ka dhënë 6 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

- Rregullorja e Brendshme e miratuar me Vendimin nr. 563 datë 25.10.2018 nuk është ndryshuar dhe rishikuar në bazë të ndryshimeve që ka pësuar struktura me Vendimin e Kuvendit nr. 25/2024.
- Titullari i AK-së nuk ka miratuar një plan të veçantë për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë, në kundërshtim me Aneksin nr. 5 të Manualit për MFK, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 4 datë 26.01.2024.
- Regjistri i Riskut nuk përmban risqe për të gjitha drejtoritë e institucionit si dhe nuk janë hartuar plane të masave për menaxhimin e risqeve, në mospërputhje me kërkesat e anekseve 4, 5, 6 dhe 7 të Manualit të MFK.
- Nga auditimi i listës së vendimeve të Komisionit të Konkurrencës në AK konstatohet se nuk ka një proces monitorimi në vazhdimësi për ato vendime të cilat kanë rezultuar me rekomandime apo kërkesa drejtuar ndërmarrjeve/autoriteteve publike referuar fushës së veprimtarisë së AK.
- Nga auditimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës konstatohet se nuk ka pasur një ndjekje në kohë reale të vendimeve për ekzekutimin e gjobave, duke qënë se mungojnë të dhëna të gjobave përpara vitit 2021. Gjithashtu evidentohet se nuk ka koherencë të vendimeve gjyqësore të pasqyruara në listën e ekzekutimeve në ndjekje nga viti në vit. Ekzekutimet e vendimeve gjyqësore nuk janë të pasqyruara në pasqyrat financiare të AK në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022.
- Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Autoritetit të Konkurrencës për periudhën në auditim u konstatuan problematika në procesin e përgatitjes së PBA, në shpenzimin e fondeve të miratuara dhe kryerjen e procesit të monitorimit.
- AK ka shlyer tarifat përmbartimore të cilat kanë qënë në ngarkim të operatorit privat MBM shpk, për një shumë që nuk përputhet me diferencën, ndërkohë që vendimet gjyqësore nuk ngarkojnë AK për shlyerjen e tarifave të përmbartimit të faturuara drejt operatorëve privatë dhe njëkohësisht cilësojnë që tarifat përmbartimore nuk parapaguhën, por paguhën në fund nga debitori. Ekzekutimi nga përmbartuesi është kryer vetëm për detyrimin pjesor në shumën 5,571,497 lekë dhe jo për shumën e plotë të detyrimit në vlerën 66,088,573 lekë. Tarifa përmbartimore e aplikueshme për shumën 5,571,497 lekë llogaritet në shumën 183,859 lekë me TVSH. (2.75% e shumës së ekzekutuar sipas udhëzimit nr. 385/7 datë 28.06.2017 *“Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi gjyqësor privat”*, i ndryshuar. Shpenzimet janë rritur si pasojë e kësaj tarife ndërkohë që në rastin e detyrimit të shoqërisë “Ç.” shpk ekzekutimi është kryer vullnetarisht me kërkesë të saj. Gjithashtu nga auditimi konstatohet se mungon Urdhri i Titullarit për kryerjen e pagesës së vendimit gjyqësor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 60 të Udhëzimit Standard të Zbatimit të Buxhetit nr. 9 datë 20.03.2018, i ndryshuar.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

- Titullari i Autoritetit të Konkurrencës të marrë masa për përmirësimin e komponentëve të MFK.
- Titullari i Autoritetit të Konkurrencës në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të marrin masa për të hartuar dhe zbatuar një mekanizëm të qëndrueshëm monitorimi për ndjekjen e zbatimit të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, veçanërisht për ato që përmbajnë rekomandime apo detyrime ndaj ndërmarrjeve dhe autoriteteve publike. Të merren masa për krijimin e një sistemi evidencash dhe raportimi të brendshëm për të matur nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe efektivitetin e vendimeve.

- Drejtoria Juridike, Integritetit dhe Çështjeve Gjyqësore së bashku me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit të marrin masa për krijimin dhe zbatimin e një sistemi të integruar dhe në kohë reale për administrimin, ndjekjen dhe raportimin e gjobave të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës, me qëllim sigurimin e plotësisë, saktësisë dhe transparencës së të dhënave.
- Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës të merren masa në drejtim të menaxhimit të buxhetit sipas drejtimeve të mëposhtme:
 - përmirësimin e procesit të planifikimit duke dokumentuar aktivitetet e GMS, plotësimin e formularëve të projekteve të investimeve përpara kërkesës për fonde të investimeve dhe përfshirjen e të gjithë fondeve të nevojshme në ndryshim të legjislacionit që shkaktojnë kërkesa buxhetore shtesë për buxhetin e Autoritetit të Konkurrencës.
 - analizimin e shmangieve të faktit të buxhetit nga plani i miratuar fillestar dhe ai i ndryshuar nëpërmjet marrjes së masave përkatëse dhe reflektimin në buxhetin e vitit pasardhës.
 - hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit nëpërmjet lidhjes së treguesve financiarë me ato jo financiarë sipas formatit standard për kryerjen e monitorimeve.
 - Nga ana e Titullarit të Autoritetit të Konkurrencës të merren masa për analizimin e pagesave të kryera dhe të arkëtohen shumat e paguara më tepër drejt përmbaruesit gjyqësor privat.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Opinion mbi auditimin e përputhshmërisë:

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës me Ligjin nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, për periudhën 01.01.2021-31.12.2025 sa i takon shkallës së ndjekjes së kriterëve për vendimet dhe përputhshmërinë për veprimtarinë buxhetore dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin për periudhën 01.01.2024-31.12.2025.

Ne kemi kryer auditimin e përputhshmërisë në përputhje me Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s) mbështetur në ISSAI 200 “Parimet e auditimit financiar”, ISSAI 2000 “Aplikimi i standardeve të auditimit financiar”, në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, të miratuar me Vendimin Nr. 245, datë 29.12.2022 të Kryetarit të KLSH, si dhe ISSAI 130- Kodi i Etikës. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 217, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së.

Refuzim për dhënien e opinionit¹

Bazuar në auditimin e kryer, për shkak të rëndësisë së çështjeve të vërejtura në paragrafin “Baza për refuzimin e opinionit” më poshtë, ne nuk jemi në gjendje të shprehim një opinion për auditimin e përputhshmërisë së realizuar në Autoritetin e Konkurrencës për periudhën objekt auditimi sipas programit të auditimit nr. 952/1 datë 13.10.2025, të ndryshuar pasi fushëveprimi i auditimit është kufizuar nga subjekti i audituar duke mos lejuar aksesin në informacion dhe dokumentacion. Ne

¹ Referuar Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 245, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit të përputhshmërisë”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq. 103), “Refuzim dhënie opinionit” jepet në rastet nëse audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për pajtueshmërinë me kriteret, dhe efektet e mundshme janë materiale dhe të përhapura.

nuk kemi qenë në gjendje të mbledhim prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për pajtueshmërinë me kriteret, dhe efektet e mundshme janë materiale dhe të përhapura, për t'u siguruar një bazë për një opinion.

Baza për refuzimin e opinionit

Për të kryer auditimin në përputhje me programin e auditimit, ne kemi kërkuar akses në praktikat e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, për ato vendime që kanë rezultuar me gjobë ndaj subjekteve përgjatë periudhës objekt auditimi 2021-2025 dhe kjo kërkesë nuk është përmbushur nga Autoriteti i Konkurrencës duke vepruar në kundërshtim me detyrimin ligjor për vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar nga KLSH. Pamjaftueshmëria e evidencës është materiale dhe e përhapur për të gjithë kërkesat e kësaj pike të programit të auditimit.

Për kryerjen e auditimit ne identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke patur si qëllim kryesor dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të AK. Në përfundim krijojmë një konkluzion final nëse çështjet janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ose nuk marrim evidencë auditimi, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 952/1 prot., datë 13.10.2025, të ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 13.10.2025 deri më datë 31.03.2026, në subjektin Autoriteti i Konkurrencës, për periudhën e veprimtarisë së subjektit, nga data 01.01.2021 deri në 31.12.2025 për përputhshmërinë e vendimeve sipas pikës 2 të programit të auditimit dhe përputhshmërinë për veprimtarinë buxhetore dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin për periudhën 01.01.2024-31.12.2025, u krye auditimi “Mbi përputhshmërinë”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. R. G., përgjegjës grupi.
2. M. V., Audituese.
3. P.K., Audituese.
4. S. D., Auditues.
5. T. Gj., Audituese

Objektivat dhe qëllimi i auditimit të përputhshmërisë është dhënia e opinionit dhe lëshimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime përgjatë periudhës objekt auditimi mbi bazën e nivelit të materialitetit dhe vlerësimit

të risqeve, si dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI. Gjithashtu objektivat përfshijnë vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij; vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)²; dhe hartimin e Raportit të Auditimit dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve, të cilat mbështeten mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Objektivi i auditimit synon në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional dhe të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga AK të rregullave, ligjeve, politikave kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve gjatë veprimtarisë së tij. Qëllimi i tij është përcaktimi i nivelit të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me aktivitetin e AK për periudhën në auditim. Auditimi synon gjithashtu në përcaktimin nga ana e audituesve:

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;
- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
- dhënien e Opinioneve dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së AK-së.

Identifikimi i çështjes. Raporti mbi auditimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së AK, ka identifikuar sipas kriterëve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave të buxhetit, veprimtarinë për monitorimin e tregjeve dhe procedurave të tjera për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe çështjet që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Gjetjet e këtij auditimi, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Raporti i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet së bashku me anekset.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Strukturat drejtuese të AK, kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Ato janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator. Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia e audituesve të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë sipas programit

²Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

të auditimit.

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në AK, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

Kriteret e vlerësimit.

-Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

-Ligji Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar;

-Ligji Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

-Ligji Nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar;

-Ligji Nr. 9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij (VKM, udhëzime APP-së etj.);

-Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

-Standardet e auditimit.

-ISSAI 100 “Parimet themelore të Auditimit të Sektorit Publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;

-ISSAI 400 (Parime parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë), që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato, duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

--ISSAI 4000 “Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;

-Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së;

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);

-Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

Metodat e auditimit. Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku.

Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimit e auditimit;
- c. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm*- duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;
- d. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- e. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirë informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Dokumentimi i auditimit. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimet dhe Verifikimet e mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport Auditimi.

³Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Informacion i përgjithshëm

Autoriteti i Konkurrencës është organ publik, i pavarur. Buxheti vjetor për financimin e veprimtarisë së Autoritetit, i cili përbën zë me vete në Buxhetin e Shtetit, miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë. Të ardhurat që krijohen në zbatim të këtij ligji, përfshirë edhe të ardhurat nga gjokat, derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe përdoren sipas akteve ligjore në fuqi. Autoriteti mban llogari të shpenzimeve dhe të të ardhurave faktike.

AK përbëhet nga Komisioni dhe nga Sekretariati. Komisioni i Konkurrencës është organi vendimmarrës kolegjial i përhershëm i Autoritetit dhe përbëhet nga pesë anëtarë ndërsa Sekretariati i cili zgjidhet nga Komisioni dhe drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, harton dhe paraqet raportet e hetimit pranë Komisionit për vendimmarrje, monitoron dhe analizon kushtet e tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive, ndjek dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të marra nga Komisioni etj.

Autoriteti, në ushtrimin e funksionit të tij, zbaton Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve kur ligji për konkurrencën parashikon ndryshe.

Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, Komisioni vendos gjoka, në masën jo më shumë se 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve nëse: japin të dhëna jo të sakta, jo të plota ose mashtruese ose nuk japin të dhëna brenda afatit kohor, të përcaktuar në vendimin e marrë. Kundër vendimeve të Komisionit për vendosjen e sanksioneve mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit.

III.2.1. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të Autoritetit të Konkurrencës

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- Programet Buxhetore Afatmesme (PBA) për periudhat 2024-2026 dhe 2025-2027;
- Projektbuxheti për vitet 2024-2025 si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit gjatë viteve ushtrimore;
- Raportet e monitorimit 4, 8 dhe 12-mujore të realizimit të buxhetit;
- Shkresat e rakordimeve me thesarin për të ardhurat dhe shpenzimet.

a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Programi Buxhetor Afatmesëm

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përcakton kontekstin afatmesëm të buxhetit vjetor. Kërkesat buxhetore të institucionit hartohen në bazë të programit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës dhe iniciativat e përcaktuara në programin e qeverisë gjatë një periudhe 3-vjeçare, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr. 7 datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” dhe udhëzimeve plotësuese vjetore përkatëse.

Nga auditimi konstatohet se nga Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2024 është ngritur Grupi i

Menaxhimit Strategjik (GMS) me shkresën nr. 222/1 datë 13.03.2024 me përbërje E.Ç., Th. K., Dh. S., A. B. dhe M. K.. Për vitin 2025 me anë të Urdhrit nr. 15/17 datë 26.03.2025 është miratuar Urdhri për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik GMS/EMP me përbërje E. Ç., Th.K., Dh. S., A. B., M. K. dhe I. K.. Megjithëse këto grupe janë ngritur nuk rezultojn të jetë dokumentuar aktiviteti i tij në drejtim të kërkesave të legjislacionit për planifikimin e buxhetit, pasi nuk ka procesverbale të mbledhjeve të realizuara dhe dokumentacion në lidhjet me vendimet e marra, përveç dy procesverbaleve të vitit 2025 për përgatitjen e kërkesave buxhetore të PBA 2026-2028. Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, AK ka hartuar dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026.

PBA 2024-2026

Nga Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 170/4 datë 28.04.2023 është dërguar PBA 2024-2026 sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 5 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026” ku janë respektuar tavanet në shumën 79,000 mijë lekë për tre vitet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 1. PBA 2024-2026, faza e parë

në mijë lekë

Përshkrimi	2023	2024	2025	2026
Shpenzime personeli 600-601	67,640	67,640	67,640	67,640
Korente të tjera 602-606	11,150	10,360	10,360	10,360
Kapitale	5,000	1,000	1,000	1,000
Totali	83,790	79,000	79,000	79,000

Burimi: Të dhënat e AK

Kërkesa shtesë janë paraqitur në shumën 5,000 mijë lekë në artikullin 602 “Udhëtime e dieta”, si rezultat i rritjes së ndjeshme të volumit të punës për shkak të hetimeve dhe inspektimeve në vend. Në fazën e dytë të PBA nga Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 170/9 datë 01.09.2023 janë dërguar kërkesat buxhetore në Ministrinë e Financave sipas taveaneve përfundimtare të shpenzimeve. Këto kërkesa janë të njëjta me fazën e parë të PBA 2024-2026 duke paraqitur dy formularë të ndryshëm për politikat e reja dhe politikat ekzistuese. Në politikat ekzistuese janë paraqitur kërkesa në shumën 79,000 mijë lekë, ndërkohë që në politikat e reja janë paraqitur kërkesa në shumën 83,000 mijë lekë për shpenzimet korente pa investimet dhe 84,000 mijë lekë bashkë me investimet. Nga auditimi konstatohet se në formularin e politikave të reja janë paraqitur të gjitha shumat e buxhetit të kërkuar vjetor dhe jo vetëm kërkesat shtesë sipas kërkesave të udhëzimit të planifikimit të buxhetit.

Me shkresën nr. 729/1 datë 22.12.2023 të Autoritetit të Konkurrencës drejtuar Ministrisë së Financave është kryer përditësimi i të dhënave në sistemin AFMIS për fazën e tretë të PBA 2024-2026 duke përcjellë formularin nr.2. Kërkesat buxhetore të përditësuara sipas ligjit të miratuar të buxhetit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 2. PBA 2024-2026, faza e tretë

në mijë lekë

Përshkrimi	2023	2024	2025	2026
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Shpenzime korrente	112,103	111,500	114,710	115,109
600		87,400	89,400	89,400
601		13,740	14,950	14,950
602		10,120	10,120	10,519
606		240	240	240

Shpenzime kapitale	1,000	1,000	1,000	1,000
231 (18AC501 - blerje pajisje informatike dhe zyre)	1,000	1,000	1,000	1,000
Totali i shpenzimeve te programit	113,103	112,500	115,710	116,109

Burimi: Të dhënat e AK

Nga auditimi konstatohen diferenca të ndjeshme ndërmjet fondeve buxhetore të kërkuara në fazën e parë dhe të dytë të PBA sipas tavanëve me fondet e miratuara në fazën e tretë të PBA 2024-2026. Këto diferenca konstatohen kryesisht për shkak të parashikimit në nivelin e fondeve për shpenzimet e personelit, përkatësisht në llogarinë e pagave dhe llogarinë e kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Nga auditimi konstatohet se në planifikim nuk janë marrë parasysh efektet e rritjes së pagave në sektorin publik sipas VKM-ve respektive në muajin Prill 2023 me efekte në vitet e ardhshme buxhetore. Kjo problematikë ka sjellë situatën e nevojës së detyruar për rritjen e fondeve në fazën e tretë të PBA, megjithëse efekti i rritjes duhej të ishte pasqyruar që në fazën e dytë të PBA 2024-2026 dhe të reflektonte në tavanet përkatës buxhetorë.

Miratimi i buxhetit për vitin 2024

Buxheti i miratuar për vitin 2024 sipas Ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” për grupin 77 “Autoriteti i Konkurrencës”, në programin buxhetor “Mbikqyrja e tregut dhe garantimi i Konkurrencës” paraqitet në shumën 112,500 mijë lekë. Fondet e miratuara në strukturën e shpenzimeve korente paraqiten në shumën 111,500 mijë lekë ndërkohë që për shpenzimet kapitale janë miratuar fonde në shumën 1,000 mijë lekë. Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës rezulton të jenë kryer përditësimet në AFMIS përse i përket fondeve të miratuara.

Me shkresën nr. 23917/77 datë 24.01.2024 është miratuar detajimi i planit të buxhetit për vitet 2024-2026 në vijim të kërkesës së AK nr. 8 datë 03.01.2024 për shpenzimet korente. Fondet e miratuara për vitin 2024 në shumën 111,500 mijë lekë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3. Miratimi i shpenzimeve korente për vitin 2024

në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
600	87,400	89,400	89,400
601	13,740	14,950	14,950
602	10,120	10,120	10,519
606	240	240	240
Totali	111,500	114,710	115,109

Burimi: Të dhënat e AK

Me shkresën nr. 23917/110 datë 30.01.2024 të Ministrisë së Financave është dërguar në AK detajimi i limitit mujor.

Buxheti i investimeve është detajuar me shkresën nr. 23917/165 datë 19.02.2024 të Ministrisë së Financave drejtuar Autoritetit të Konkurrencës në vijim të kërkesës nr. 8 datë 03.01.2024 të AK në shumën 1,000 mijë lekë në projektin 18AC501 “Pajisje informatike dhe zyre”.

Ndryshimet e buxhetit gjatë vitit 2024

Ndryshimet në planin buxhetor për shpenzimet korente janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 4. Ndryshimet e buxhetit gjatë vitit 2024

në mijë lekë

Artikulli	Buxheti fillestar	Buxheti perfundimtar	Ndryshimet
600	87,400	87,400	0
601	13,740	13,740	0
602	10,120	9,820	-300
606	240	1,143	903
Totali	111,500	112,103	603

Burimi: Të dhënat e AK

-Gjatë vitit 2024 është kryer një ndryshim i buxhetit në shumën 353 mijë lekë në artikullin 606 duke shtuar buxhetin në programin 4120 të AK dhe pakësimin në të njëjtën shumë të programit 01130 të aparatit të MFE. Ky ndryshim është miratuar me shkresën nr. 11812/1 datë 17.09.2024 të MF, në përgjigje të shkresës nr. 581/1 datë 02.09.2024 të AK nëpërmjet së cilës është kërkuar akordimi i fondit për kryerjen e pagesës pas ndërprerjes së funksionit të fundit për ish këshilltarin e kabinetit të kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës zj. Adriana Berberi.

-Me shkresën nr. 3189 datë 08.03.2024 nga Ministria e Financave është miratuar detajimi i planit të fondit të veçantë për Autoritetin e Konkurrencës në shumën 250 mijë lekë në llogarinë ekonomike 600. Me shkresën nr. 3189/3 datë 21.10.2024 Ministria e Financave ka dërguar korrigjimin e artikullit për detajimin e planit të fondit të veçantë nëpërmjet pakësimit në llogarinë 600 dhe shtesës në llogarinë 606 të shumës prej 250 mijë lekë. Ky miratim është kryer në vijim të kërkesës së AK nr. 234/1 datë 18.10.2024 për kalimin në llogarinë 606 sipas pikës 64 të udhëzimit nr.1 datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit për vitin 2024”.

Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar rialokim fondi me shkresën nr. 46 datë 12.01.2024 drejtuar MF për pakësimin e artikullit 602 dhe shtesën e artikullit 606 në shumën 300 mijë lekë për pagesat e telefonave të funksionarëve publikë sipas VKM nr. 673 datë 02.09.2020, kërkesë e cila është miratuar nga MF me shkresë nr. 1057/1 datë 25.01.2024.

Realizimi i buxheti për vitin 2024

Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës është kryer rakordimi vjetor për realizimin e buxhetit nëpërmjet akt-rakordimit të nënshkruar ndërmjet degës së thesarit dhe specialistit të buxhetit, nëpunësit zbatues dhe nëpunësit autorizues.

Tabela nr. 5. Realizimi i buxheti për vitin 2024

në mijë lekë

Kod produkti	Artikulli	Plani përfundimtar	Realizimi	Diferenca
97701AA	600	87,400	80,827	- 6,573
97701AA	601	13,740	12,869	- 871
97701AA	602	9,820	7,035	- 2,785
18AC501	231	1,000	921	- 79
97701AA	606	1,143	1,066	- 77
Totali		113,103	102,718	- 10,385

Burimi: Të dhënat e AK

Referuar planit fillestar dhe atij përfundimtar konstatohen diferenca në zërin e shpenzimeve korente përse i përket shpenzimeve operative, zërit 602 dhe transfertave drejt të tretëve. Nga auditimi konstatohet se buxheti i vitit 2024 rezulton të mos jetë realizuar për shumën 10,385 mijë lekë, me mos realizim më të madh në zërin e pagave në shumën 6,573 mijë lekë dhe zërin e shpenzimeve operative në shumën 2,785 mijë lekë. Megjithëse në planifikimin fillestar është kërkuar më shumë buxhet se ai i miratuar për shpenzimet operative, konstatohet se nuk është realizuar buxheti me rreth 28% të planit përfundimtar për artikullin 602.

PBA 2025-2027

Me shkresën nr. 344 datë 30.04.2024 nga Autoriteti i Konkurrencës është dërguar në Ministrinë e Financave PBA e fazës së parë për periudhën 2025-2027. Me shkresën nr. 288/2 datë 02.09.2024 nga Autoriteti i Konkurrencës është dërguar në Ministrinë e Financave PBA për fazën e dytë 2025-2027.

Me shkresën datë 17.12.2024 të Ministrisë së Financave është kërkuar përditësimi i të dhënave në sistemin AFMIS për fazën e tretë të PBA 2025-2027. Me shkresën nr. 834/1 datë 20.12.2024 nga

Autoriteti i Konkurrencës është dërguar në Ministrinë e Financave faza e tretë e PBA 2025-2027. Buxheti sipas fazës së tretë të PBA 2025-2027 paraqitet i ndarë në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 6. PBA 2025-2027, faza e tretë

në mijë lekë

Përshkrimi	2024	2025	2026	2027
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Shpenzime korrente	112,103	114,250	114,250	115,109
600		88,150	88,150	88,150
601		13,740	13,740	13,740
602		12,120	12,120	12,979
606		240	240	240
Shpenzime kapitale	1,000	10,000	1,000	1,000
231 (18AC501 - blerje pajisje informatike dhe zyre)	1,000	10,000	1,000	1,000
Totali i shpenzimeve te programit	113,103	124,250	115,250	116,109

Burimi: Të dhënat e AK

Miratimi i buxhetit

Me shkresën nr. 17548 datë 23.12.2024 është bërë detajimi i buxhetit nga Ministria e Financave për shpenzimet operative në programin 04120 “Mbikqyrja e tregut dhe advokacia e Konkurrencës” për vitet 2025-2027 nga të cilat 250 mijë lekë fond i veçantë dhe buxhet të miratuar në shumën 114,250 mijë lekë për vitin 2025, detajuar si më poshtë:

Tabela nr. 7. Miratimi i buxhetit për vitin 2025

në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
600	88,150	88,150	88,150
601	13,740	13,740	13,740
602	12,120	12,120	12,979
606	240	240	240
Totali	114,250	114,250	115,109

Burimi: Të dhënat e AK

Shpenzimet për investime janë miratuar në shumën 10,000 mijë lekë për vitin 2025, ku me shkresën nr. 271 datë 03.03.2025 është kthyer përgjigje kërkesës së Ministrisë së Financave nr. 17548 datë 23.12.2024 për detajimin e planit të buxhetit për periudhën 2025-2027.

Tabela nr. 8. Detajimi i planit të investimeve për periudhën 2025-2027

në mijë lekë

Kodi i produktit	Shuma 2025	Shuma 2026	Shuma 2027
Blerje pajisje zyrash dhe informatike	8,820	1,000	1,000
Mobilim zyrash	1,000		
Pajisje fikse zjarri	60		
Blerje mjete pune për mirëfunksionimin e pajisjeve kompjuterike	120		
TOTALI	10,000	1,000	1,000

Burimi: Të dhënat e AK

Bashkëlidhur kësaj shkrese janë dërguar shtojca 2 (F-2) për projektet e investimit të vitit 2025. Nga auditimi konstatohet se procesi i detajimit të investimeve publike për Autoritetin e Konkurrencës ka zgjatur më shumë se dy muaj nga kërkesa e Ministrisë së Financave dhe formularët e investimeve janë dërguar vetëm me anë të kësaj shkrese, jo që në fillim të procesit të planifikimit. Nuk ka argumentim në lidhje me zgjatjen e afateve për detajimin e investimeve publike, megjithëse informimi mbi nivelin e fondeve të investimeve është kryer që në muajin dhjetor 2024. Gjithashtu shtojca 2 është dërguar vetëm pasi janë miratuar fondet e investimeve dhe jo në momentin e dërgimit të kërkesës për fonde buxhetore, në kundërshtim me procedurat e

përcaktuara në udhëzimin standard për përgatitjen e buxhetit dhe VKM për procedurat e menaxhimit të investimeve publike.

Detajimi i fondeve të investimeve është kryer në projektet e mëposhtme:

Tabela nr. 9. Detajimi i fondeve të investimeve për periudhën 2025-2027

në mijë lekë

Kodi i produktit	Emërtimi i produktit	2025	2026	2027
97701AA	Blerje paisje zyrash dhe informatike	8,820	1,000	1,000
97701AA	Mobilim zyrash	1,000		
97701AA	Paisje fikëse zjarri	60		
97701AA	Blerje mjete pune për mirëfunksionimin e paisjeve kompjuterike	120		
TOTALI		10,000	1,000	1,000

Burimi: Të dhënat e AK

Ndryshimet e buxhetit për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, buxheti i Autoritetit të Konkurrencës ka ndryshuar me rialokime dhe si pasojë e ndryshimeve të Aktit Normativ sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 10. Ndryshimet e buxhetit për vitin 2025

në mijë lekë

Artikulli	Buxheti fillestar	Buxheti përfundimtar	Ndryshimet
600	88,150	89,300	1,150
601	13,740	12,240	-1,500
602	12,120	27,686	15,566
606	240	874	634
231	10,000	6,952	-3,048
230		948	948
Totali	124,250	138,000	13,750

Burimi: Të dhënat e AK

-Me shkresën nr. 2079/1 datë 04.02.2025 të Ministrisë së Financave është miratuar kërkesa me nr. 144 datë 27.01.2025 duke pakësuar fondet në shumën 384 mijë lekë në artikullin 602 dhe duke shtuar në të njëjtën shumë fondet në artikullin 606. Kërkesa për këtë ndryshim është bazuar në VKM nr.673 datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, pika 14. Artikulli 606 është shtuar si pasojë e detajimit të planit të fondit të veçantë në shumën 250 mijë lekë sipas shkresës së miratimit të Ministrisë së Financave me nr. 2707 datë 07.02.2025.

-Me shkresën nr. 473 datë 13.05.2025 të Autoritetit të Konkurrencës është kërkuar të bëhet kalimi i shumës 948 mijë lekë nga llogaria 231 në llogarinë 230 për efekt të përdorimit si shpenzime për “Blerje licence, antivirus, paketa office për kompjutera”. Kjo kërkesë është miratuar nga Ministria e Financave me shkresën nr. 8033/1 datë 27.05.2025.

-Në kuadër të ndryshimeve të kryera me akt normativ në fund të vitit buxhetor, nga Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 731 datë 18.08.2025 është kërkuar rikthimi i shumave të arkëtuara për gjobat e vendosura dhe arkëtuara në vitet e mëparshme, të cilat sipas vendimit nr. 127 datë 30.01.2025 të Gjykatës Administrative të Apelit kanë lënë në fuqi Vendimin nr. 1584 datë 15.06.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë për shfuqizimin e Vendimit nr. 874 datë 25.03.2022 të Autoritetit të Konkurrencës. Sipas kësaj kërkesë, detyrimet për tju kthyer subjekteve paraqiten në shumën 7,087,994 lekë për subjektin “Ç.” shpk dhe në shumën 8,693,597 lekë për subjektin “M.” shpk. Nga auditimi konstatohet se kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe për asyetimin e kësaj praktike nga subjekti i audituar është vendosur në dispozicion memo nr. 905/1 datë 12.05.2025 ku është vlerësuar se nuk plotësohen kushtet e parashikuara në ligjin 49/2012 “Për Gjykatat Administrative në Republikën e Shqipërisë”

dhe sanksionet që parashikohen në ligjin nr. 8116 datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”.

Nga auditimi konstatohet se këto detyrime janë paguar me urdhër shpenzimet:

- nr. 264 datë 31.12.2025 në shumën 7,087,994 lekë për subjektin “Ç.” shpk, me dokumentacion bashkëngjitur, kërkesën e subjektit “Ç.” shpk nr. 613 datë 23.06.2025, Urdhër nr. 1152 datë 31.12.2025 dhe vendimet e gjykatave.

- nr. 265 datë 31.12.2025 në shumën 8,693,597 lekë për subjektin “M.” shpk me dokumentacion bashkëngjitur lajmërim për ekzekutim vullnetar të përmbarues gjyqësor privat E. O. (ku citohet kthimi i shumës prej 8,693,597 lekë), Urdhër nr. 1152 datë 31.12.2025 dhe vendimet e gjykatave. Nga analiza e ekzekutimit të vendimeve me gjobë të Autoritetit të Konkurrencës konstatohet se nga subjekti “Ç.” shpk është ekzekutuar plotësisht në shumën 7,087,994 lekë detyrimi sipas vendimit nr. 874 datë 25.03.2022 të Autoritetit të Konkurrencës, ndërsa nga subjekti “M.” shpk është ekzekutuar pjesërisht në shumën 5,571,497 lekë nga vlera totale e detyrimit në shumën 66,088,573 lekë sipas vendimit nr. 874 datë 25.03.2022 të Autoritetit të Konkurrencës. Përsa më sipër konstatohet se ndryshojnë vlerat e arkëtuara nga vlerat e rikthyer drejt përmbaruesit përsa i përket subjektit M., pasi nga 5,571,497 lekë të arkëtuara në vite, janë rikthyer 8,693,597 lekë ose një diferencë prej 3,122,100 lekë. Nga AK është vendosur në dispozicion shkresa nr. 542/4 datë 30.10.2025 të përmbaruesit drejtuar AK ku citohet se *“ekzekutimi është kryer në vlerën prej 8,693,597 lekë, nga të cilat 3,172,252 lekë tarifa e shërbimit përmbarimor”*. Nga auditimi i praktikës së pagesës konstatohet se bashkëngjitur nuk ka faturë për shërbimin përmbarimor që të justifikojë kryerjen e pagesës në këtë shumë, por pas kërkesës për informacion është vendosur në dispozicion fatura nr. 86/2022 datë 24.08.2022 e përmbaruesit gjyqësor E. O. drejtuar M. shpk në shumën 3,172,250 lekë. Pra AK ka shlyer tarifën përmbarimore të cilat kanë qenë në ngarkim të operatorit privat M. shpk, ndërkohë që vendimet gjyqësore nuk ngarkojnë AK për shlyerjen e tarifave të përmbarimit të faturuara drejt operatorëve privatë. Gjithashtu ekzekutimi nga përmbaruesi është kryer vetëm për detyrimin pjesor në shumën 5,571,497 lekë dhe jo për shumën e plotë të detyrimit në shumën 66,088,573 lekë. Tarifa përmbarimore e aplikueshme për shumën 5,571,497 lekë llogaritet në shumën 183,859 lekë me TVSH. (2.75% e shumës së ekzekutuar sipas udhëzimit nr. 385/7 datë 28.06.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi gjyqësor privat”, i ndryshuar. Shpenzimet janë rritur si pasojë e kësaj tarife ndërkohë që në rastin e detyrimit të shoqërisë “Ç.” shpk ekzekutimi është kryer vullnetarisht me kërkesë të saj. Kryerja e pagesës më tepër nga AK është në kundërshtim me Udhëzimin e përbashkët të MF dhe MD nr. 385/7 datë 28.06.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, pika 7 dhe pika 9.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se mungon Urdhri i Titullarit për kryerjen e pagesës së vendimit gjyqësor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 60 të Udhëzimit Standard të Zbatimit të Buxhetit nr. 9 datë 20.03.2018, i ndryshuar, ku përcaktohet *“Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa miratimin e titullarit.”*. Vlera 2,938,241 lekë e paguar më tepër ndaj përmbaruesit gjyqësor privat përbën dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit.

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi nëpunësi zbatues, nëpunësi autorizues, Drejtor i Drejtorisë Juridike, Integritetit dhe Cështjeve Gjyqësore dhe Titullari i Institucionit, sipas përgjegjësive dhe kompetencave të përcaktuara në Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, dhe Rregulloren e

brendshme të Autoriteti të Konkurrencës miratuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 563 datë 25.10.2018.

-Në vijim, me shkresën nr. 1044 datë 05.12.2025 Autoriteti i Konkurrencës ka bërë me dije pamundësinë e realizimit të një procedure prokurimi në shumën 2,100 mijë lekë në fondin e investimeve dhe ka kërkuar kalimin e këtyre fondeve në buxhetin e vitit 2026. Me shkresën nr. 1064, Autoriteti i Konkurrencës ka dërguar në Ministrinë e Financave fondet e lira për vitin 2025 dhe nevojat për fonde shtesë për vitin 2026 ku ka paraqitur mosrealizime për vitin 2025 në shumën 16,588 mijë lekë dhe nevoja për fonde shtesë për vitin 2026 në shumën 30,803 mijë lekë. Ministria e Financave me shkresën nr. 18059 datë 22.12.2025 ka detajuar ndryshimet e buxhetit me Aktin Normativ nr.11 datë 19.12.2025 ku në zërin e investimeve janë pakësuar fondet në artikullin 231 në shumën 2,100 mijë lekë. Në zbatim të këtij akti normativ Ministria e Financave ka përcjellë me shkresën nr. 17564/1 datë 30.12.2025 ndryshimet në zërat e shpenzimeve operative, ku janë pakësuar fondet në artikullin 601 në shumën 1,500 mijë lekë dhe janë shtuar fondet në artikullin 600 në shumën 1,150 mijë lekë dhe në artikullin 602 në shumën 15,950 mijë lekë.

Realizimi i buxhetit për vitin 2025

Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës është kryer rakordimi për realizimin e buxhetit nëpërmjet akt-rakordimit të nënshkruar ndërmjet degës së thesarit dhe specialistit të buxhetit, nëpunësit zbatues dhe nëpunësit autorizues.

Tabela nr. 11. Realizimi i buxhetit për vitin 2025

në mijë lekë

Kod projekti	Llogari	Plani	Realizimi	Diferenca plan-fakt
97701AA	600	89,300	76,179	13,121
97701AA	601	12,240	12,157	84
97701AA	602	27,686	25,957	1,729
25AB001	230	948	948	0
18AC501	231	5,772	4,647	1,125
18AC502	231	1,000	758	242
18AC503	231	60		60
18AC504	231	120		120
97701AA	606	874	526	348
Totali		138,000	121,172	16,828

Burimi: Të dhënat e AK

Nga auditimi konstatohet se për vitin 2025, buxheti është realizuar në shumën 121,172 mijë lekë, nga 138,000 mijë lekë sipas planit të ndryshuar ose 87% e tij, me një mos realizim në shumën 16,828 mijë lekë. Mos realizimet më të mëdha paraqiten në zërin e pagave në shumën 13,121 mijë lekë, për një realizim në shumën 76,179 mijë lekë përkundërt planit të ndryshuar prej 89,300 mijë lekë. Megjithëse zëri i pagave është shtuar në shumën 1,150 mijë lekë në fund të vitit 2025, ai paraqitet me mos realizim në rreth 13,121 mijë lekë. Edhe zëri i shpenzimeve operative paraqitet me mosrealizim në shumën 1,729 mijë lekë, për një vlerë të shpenzuar prej 25,957 mijë lekë përkundërt një plani përfundimtar prej 27,686 mijë lekë. Në zërat e investimeve, dy projekte nuk janë realizuar fare ndërkohë që mos realizimi total në fondet e investimeve paraqitet në shumën 1,547 mijë lekë, si diferencë e realizimit në shumën 6,353 mijë lekë përkundërt planit të ndryshuar prej 7,900 mijë lekë.

Mbi të ardhurat e realizuara për periudhën në auditim

Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës janë kryer rakordimet me degën e thesarit për të ardhurat e realizuara. Për vitin 2024, janë realizuar të ardhura në shumën 152,873,723 lekë, nga të cilat të ardhura nga përqëndrimet dhe autorizimet në shumën 27,865,000 lekë, të ardhura nga gjobat në

shumën 124,988,723 lekë dhe të ardhura të tjera në shumën 20,000 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 12. Të ardhurat e realizuara për vitin 2024

në mijë lekë

Kodi i institucionit	Llogaria ekonomike	Përshkrimi	Shuma
1077001	7113099	Të ardhura nga përqëndrimet, autorizimet	27,865
1077001	7113099	Të ardhura nga gjobat	124,989
1077001	7113099	Të ardhura të tjera	20
Totali			152,874

Burimi: Të dhënat e AK

Për vitin 2025, janë realizuar të ardhura në shumën 71,425 mijë lekë, nga të cilat të ardhura nga përqëndrimet dhe autorizimet në shumën 32,200 mijë lekë, të ardhura nga gjobat në shumën 39,208 mijë lekë dhe të ardhura të tjera në shumën 17 mijë lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 13. Të ardhurat e realizuara për vitin 2025

në mijë lekë

Kodi i institucionit	Llogaria ekonomike	Përshkrimi	Shuma
1077001	7113099	Të ardhura nga përqëndrimet, autorizimet	32,200
1077001	7113099	Të ardhura nga gjobat	39,208
1077001	7113099	Të ardhura të tjera	17
Totali			71,425

Burimi: Të dhënat e AK

Referuar procedurës së ndjekur për arkëtimin e të ardhurave, konstatohet se nga financa nuk kontabilizohen debitorët që krijojnë vendimet e Autoritetit të Konkurrencës, veprim jo në përputhje me Udhëzimin nr. 08 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 05 datë 21.02.2022. Nga Drejtoria e Financës mbahen evidenca vetëm mbi arkëtimet që kryhen përgjatë vitit pas njoftimit nga strukturat e thesarit. Vendimet e Komisionit dërgohen për ndjekje në Drejtorinë Juridike, Integritetit dhe Çështjeve Gjyqësore dhe nga auditimi konstatohet se nuk ka një procedurë rakordimi ndërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit (DBNJBK) dhe Drejtorisë Juridike për arkëtimet e kryera në fund të periudhave raportuese përkatëse. Grupi i auditimit ka kërkuar të dhënat analitike të të ardhurave të realizuara, të cilat janë përcjellë vetëm për arkëtimet e kryera për të ardhurat nga gjoba dhe jo për të ardhurat nga përqëndrimet dhe autorizimet, me argumentin se ato ndiqen nga Drejtoria e Përqëndrimeve. Nga auditimi konstatohet se procesi i arkëtimin të të ardhurave nga përqëndrimet nuk kryhet i administruar nga DBNJBK pasi mungon gjurma dokumentare dhe të dhënat analitike në regjistra mbi arkëtimet e kryera në bazë të faturave për arkëtim, të cilat duhet të jenë me rend kronologjik për të bërë të mundur konstatimin e të ardhurës rast pas rasti dhe më pas arkëtimin e saj.

Mbi monitorimin e buxhetit

Me shkresën nr. 453 datë 21.06.2024 është dërguar raporti i monitorimit të shpenzimeve të programit buxhetor për 4 mujorin e parë të vitit 2024. Ky raport ka bashkëngjitur anekset përkatëse dhe analizën e veprimtarisë së AK, duke përfshirë veprimtarinë e autoritetit në funksion të vendimmarrjes në përqëndrime apo vendime me rekomandime. Konstatohet se nuk ka një analizë të shpenzimeve buxhetore të hollësishme në këtë raport sipas kërkesave të udhëzimit përkatës.

Me shkresën nr. 27.09.2024 nga Autoriteti i Konkurrencës është dërguar në Ministrinë e Financave raporti i monitorimit të shpenzimeve të programit buxhetor për 8-mujorin 2024. Ky raport ka

bashkëngjitur anekset përkatëse dhe analizën e veprimtarisë së AK, duke përfshirë veprimtarinë e autoritetit në funksion të vendimmarrjes në përqëndrime apo vendime me rekomandime. Konstatohet se nuk ka një analizë të shpenzimeve buxhetore të hollësishme në këtë raport sipas kërkesave të udhëzimit përkatës.

Me shkresën nr. 263 datë 26.02.2025 nga Autoriteti i Konkurrencës është dërguar në Ministrinë e Financave raporti i monitorimit të shpenzimeve të programit buxhetor për vitin 2024. Në këtë raport ka bashkëngjitur anekset përkatëse dhe një raport mbi realizimin e shpenzimeve dhe të ardhurave. Në këtë raport nuk ka një analizë të hollësishme mbi mosrealizimet e shpenzimeve për vitin 2024.

Me shkresën nr. 645 datë 08.07.2025 është dërguar raporti i monitorimit të shpenzimeve nga Autoriteti i Konkurrencës në Ministrinë e Financave raporti i monitorimit të shpenzimeve për 4-mujorin e parë të vitit 2025. Ky raport ka të bashkëngjitur anekset e përcaktuara në udhëzimin për hartimin e tij si dhe një analizë të shpenzimeve buxhetore të realizuara. Megjithatë konstatohet se nuk ka një analizë të veprimtarisë së institucionit përse i përket të ardhurave të realizuara.

Me shkresë nr. 989 datë 12.11.2025 nga ana e Autoritetit të Konkurrencës është dërguar në MF Raporti i Monitorimit 8-mujor të vitit 2025 për shpenzimet sipas programit buxhetor. Në lidhje me pjesën jo financiare të raportit konstatohet se nuk integrohet me treguesit financiar të analizuar. Me shkresë nr. 217/1 datë 27.02.2026 nga ana e Autoritetit të Konkurrencës është përcjellë në MF raporti 12-mujor i monitorimit të shpenzimeve për vitin 2025.

Nga auditimi mbi monitorimin e buxhetit të Autoritetit të Konkurrencës konstatohet se raportet e monitorimit të hartuara nga institucioni përgjithësisht nuk kanë një analizë të hollësishme mbi treguesit kryesorë të buxhetit, duke qenë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 14 datë 30.05.2023 të MF “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, ku në pikën 4 dhe 5 përcaktohet që *“Monitorimi është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve të performancës së synuar me treguesit faktikë të realizuar. Monitorimi i objektivave bëhet bazuar në treguesit përkatës të performancës, ndërsa monitorimi i produkteve bëhet në sasi dhe në vlerë. Pra monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.”*. Raportet e monitorimit të hartuara nga Autoriteti i Konkurrencës nuk ndjekin përcaktimet e pikës 49 të udhëzimit të mësipërm të MF ku përcaktohet *“Raporti i monitorimit i përgatitur nga ministritë dhe institucionet qendrore duhet të përmbajë: a. Informacion sipas formatit standard narrativ të raportit të monitorimit të buxhetit, të përcaktuar në Shtojcën nr.3 të këtij udhëzimi; b. Anekset e monitorimit të gjeneruara në modulën e BPPM në sistemin AFMIS si më poshtë:....”*, pasi nuk janë sipas formatit narrativ dhe jo të gjithë anekset janë pjesë përbërëse e dokumentacionit të paraqitura si evidencë auditimi.

Për problematikat e mësipërme mbajnë përgjegjësi sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10296/2010 datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, Titullari, z. D. B. me funksion Kryetar i Autoritetit Kontraktor, Nëpunësi Autorizues z. E. C. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, z. Th. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit dhe zj. I.K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, Integritetit dhe Cështjeve Gjyqësore.

III.2.2. Veprimtaria e institucionit mbi monitorimin e tregjeve dhe procedurave të tjera për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2023 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore rregulluese.

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit nr. 952/1, datë 13.10.2025, i ndryshuar u auditua dokumentacioni si më poshtë:

- Lista e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës për vitet 2021-2025
- Buletinet zyrtare tremujore të publikuara në faqen e Autoritetit të Konkurrencës
- Informacion në format Excel mbi proceset gjyqësore lidhur me vendimet
- Informacion në format Excel mbi arkëtimet e vendimeve me gjobë

Veprimtaria e AK përfshin marrjen e vendimeve nga ana e Komisionit të Konkurrencës në lidhje me çështjet e përqëndrimeve në tregje si dhe ndalimin e veprimtarive abuzuese në tregje në lidhje me pozitën e ndërmarrjeve/aktorëve të ndryshëm në formën e pozitës dominuese apo marrëveshjeve të fshehta/ndaluara referuar Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Për realizimin e këtyre funksioneve dhe objektivave, nga AK nëpërmjet Sekretariatit të Konkurrencës kryhen inspektime administrative në tregje dhe monitorime, të cilat ndjekin fazat e monitorimit/hetimit paraprak dhe në vijim monitorimit/hetimit të thelluar. Në përfundim të fazave të hetimit administrativ, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në punën e kryer nga drejtoritë përkatëse të autoritetit dhe nëpërmjet Sekretariatit, merr vendimet përkatëse sipas gjetjeve dhe situatës specifike. Masat që merren nga AK shprehen në vendimet e Komisionit dhe mund të përfshijnë gjopa të cilat konsiderohen titull ekzekutiv dhe në vijim kërkohet ekzekutimi i tyre i detyrueshëm pas konfirmimit në rrugë gjyqësore nëpërmjet përmbartimit në rast refuzimi për pagesë vullnetare nga ana e palës së gjobitur.

Për realizimin e pikës 2 të programit të auditimit për periudhën objekt auditimi, u kërkuar informacione/dokumentacione, të cilat nuk u vendosën në dispozicion nga Autoriteti i Konkurrencës. Fillimisht, AK nëpërmjet shkresës nr. 873/2 date 22.10.2025 ka shprehur në KLSH mosdakordësinë dhe mos vënien në dispozicion të dokumentacionit për zbatimin e drejtimit nr. 2 të programit të auditimit, për të cilën nga KLSH u kthye përgjigje. Pas kësaj përgjigje, me email të datës 17.11.2025 u kërkuar përsëri vendosja në dispozicion e dokumentacionit të kërkuar si më poshtë:

- praktikën e vendimmarrjes së atyre vendimeve që kanë rezultuar me gjobë ndaj subjekteve përgjatë periudhës objekt auditimi 2021-2025, (duke përfshirë dosjen e plotë të dokumentave të punës, relacionet, komunikimet etj që kanë mbështetur praktikën administrative deri në daljen e vendimit)
- listën e të gjitha vendimeve të AK në rend kronologjik nga 01.01.2021-31.12.2025 me fushat: numër vendimi, datë vendimi, titulli i vendimit).
- listën e të gjitha vendimeve me gjobë me efekte financiare të mbartura nga vitet përpara periudhës objekt auditimi, që rezultojnë në ndjekje nga AK nga data 01.01.2021-31.12.2025).

1. Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës nuk u vendosën në dispozicion dokumentacionet e kërkuara, duke mos paraqitur asnjë praktikë për vendimet që kanë rezultuar me gjobë përgjatë periudhës objekt auditimi, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 26 “Aksesit në dokumentat zyrtare” të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” ku përcaktohet “1. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë për të pasur

akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuar në këtë ligj, që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial, dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore”. Konstatohet se megjithëse janë paraqitur kërkesa për informacion, kanë kaluar afatet e përcaktuara në Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, referuar nenit 15 për rastet e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar nga KLSH ku përcaktohet “..dh) të pyesë dhe të marrë përgjigje, me shkrim ose me gojë, nga subjektet e audituara ose punonjësit e tyre, brenda 1 jave nga data e paraqitjes së një kërkesë paraprake; e) në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, t’u kërkojë subjekteve të audituara që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej tij;..”. nenit 10 “Kompetencat”, nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, si dhe me Ligjin nr. 8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, Pjesa e Katërmëdhjetë, “Kontrolli i Lartë i Shtetit” nenet 162 dhe 163.

Për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar për auditimin e drejtimit 2 të programit të auditimit mban përgjegjësi Titullari i Institucionit.

Përsa më sipër fushëveprimi i këtij auditimi ka qenë i kufizuar duke qenë se nuk është mundësuar zbatimi i programit të auditimit nr. 952/1, datë 13.10.2025, i ndryshuar.

2. Është paraqitur lista e të gjitha vendimeve në rend kronologjik si më poshtë:

- Gjatë vitit 2021 nga ana e Autoritetit të Konkurrencës janë marrë 94 vendime gjithsej.
- Gjatë vitit 2022 nga ana e Autoritetit të Konkurrencës janë marrë 99 vendime gjithsej.
- Gjatë vitit 2023 nga ana e Autoritetit të Konkurrencës janë marrë 93 vendime gjithsej.
- Gjatë vitit 2024 nga ana e Autoritetit të Konkurrencës janë marrë 102 vendime gjithsej.
- Gjatë vitit 2025 nga ana e Autoritetit të Konkurrencës janë marrë 104 vendime gjithsej.

Referuar përshkrimit të listës së vendimeve të Autoritetit të Konkurrencës, pjesa më e madhe e vendimeve lidhen me përqëndrimet e kompanive të ndryshme sipas kërkesave të legjislacionit që kërkon miratimin nga ana e Autoritetit të ndryshimeve në pronësi në rastin e përthithjeve/bashkimeve të kompanive në tregun e brendshëm apo të huaj.

Një pjesë e konsiderueshme e vendimeve lidhet me vendimmarrjet për hapjen e hetimeve paraprake/thelluara në tregje dhe masat e marra në përfundim të hetimeve të cilat mund të rezultojnë në mbyllje hetimi/vendosje kushtesh dhe detyrimesh/vendosje gjobash/kërkesa për informacion, etj.

Pjesa tjetër e vendimmarrjes lidhet me vendime për dhënie rekomandimesh autoriteteve publike, miratim aktesh nënligjore si udhëzime apo rregullore, vendime për zbatimin e masave të parashikuara më parë, etj.

Nga auditimi konstatohet se për vendimet e marra ndër vite nuk ka një proces monitorimi në vazhdimësi për ato vendime të cilat kanë rezultuar me rekomandime apo kërkesa drejtuar ndërmarrjeve apo autoriteteve publike referuar fushës së veprimtarisë së AK. Mungesa e një sistemi monitorimi të vazhdueshëm në formën e një mekanizimi të ndjekjes nëpërmjet inspektimeve tematike apo detyrimeve për raportim, bën të pa mundur vlerësimin e veprimtarisë në drejtim të vendimmarrjes së Autoritetit të Konkurrencës. Këto veprime rezultojnë në

kundërshtim me Ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 28 “Përgjegjësitë e Sekretariatit” ku përcaktohet se: “Sekretariati, për ndjekjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, ka këto përgjegjësi: d) ndjek dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të marra nga Komisioni.”

3. Përsa i përket vendimeve në lidhje me masat financiare të mbartura nga vitet e kaluara, nga ana e Autoritetit të Konkurrencës nuk është vendosur në dispozicion një listë në ndjekje në 01.01.2021 me praktikën e vendimeve para vitit 2021, me pretendimin se kjo listë nuk është paraqitur gjatë dorëzimit të detyrës. Nga ana e Autoritetit është paraqitur informacion në lidhje me listën e vendimeve të ekzekutuara përgjatë periudhës 2022-2025, ndërkohë që për vitin 2021 janë paraqitur vetëm vendimet që kanë sjellë lindjen e detyrimeve financiare të subjekteve të gjobitura. Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi nuk ka pasur një ndjekje në kohë reale të vendimeve me gjobë të Autoritetit të Konkurrencës pasi referuar materialeve të vendosura në dispozicion, në listën e ekzekutimeve në ndjekje për vitin 2023, paraqiten vendime të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në listën e ekzekutimeve në ndjekje në vitin 2022. Kjo praktikë nuk rezulton të jetë e konsoliduar edhe me funksionin e financës ku me daljen e vendimit administrativ të njihen debitorët në kontabilitet dhe e drejta për të arkëtuar për gjobat e vendosura. Në fund të periudhës objekt auditimi konstatohet se nga ana e Autoritetit të Konkurrencës janë në proces ndjekje vendimet ndër vite për rastet e mëposhtme:

Tabela nr. 14. Vendimet e AK në proces ndjekje në mijë lekë

VKK	URDHËR EKZEKUTIMI	DEBITOR	GJOBA	PËRMBARUES	STATUSI
696 datë 11.06.2020	1005 datë 10.12.2020	D.	5,052	E. O.	Në proces
766 datë 22.01.2021	1119 datë 06.06.2022	N.	1,000	E. O.	në proces ekzekutimi, ekzekutuar pjesërisht
874 datë 25.03.2022	31134 datë 13.06.2022	M. SHPK	66,089	E. O.	Ekzekutuar pjesërisht në vlerën 5,571,497 në 2022, hequr pezullimi në 17 janar 2023 nga Gjykata e Lartë, Pezulluar veprimet përmbareme me vendim dt 22.07.2024 të shkallës së parë Shfuqizuar vendimi i KK me vendim e Gjykatës së Apelit nr. 127, datë 30.01.2025
		C.	7,088		Ekzekutuar plotësisht, Shfuqizuar vendimi i KK me vendim e Gjykatës së Apelit nr. 127, datë 30.01.2025
		A.	118,978		Pezulluar ekzekutimi, Shfuqizuar vendimi i KK me vendim e Gjykatës së Apelit nr. 127, datë 30.01.2025

918 datë 26.10.2022	2324 datë 14.11.2022	B.	19,863	E.	Në proces
290 datë 23.07.2013	1090 datë 04.07.2022	"F.	1,601	E	Në proces, ekzekutuar pjesërisht për disa debitorë, nga 30.07.2024
		"T." Shpk	1,202		
		"A." Shpk	615		
		"T.	2,131		
		"P.	531		
66 datë 18.12.2007	3357 datë 22.10.2010	B.	179	Transferuar nga Permbarimi Shtetëror të S.N. dhe pastaj në E.	Në proces
		H.	173		Në proces
		B.	235		Në proces
996 datë 05.07.2023 1004 datë 20.07.2023 1017 datë 25.09.2023	3286 datë 30.07.2024	A.SHA	7,161	E. O.tetor 2024	Pezulluar me vendim të ndërmjetëm datë 14.11.2024
		I.SHPK	7,100		Pezulluar me vendim të ndërmjetëm datë 14.11.2024
		T.	254		Ekzekutuar plotësisht
1145 datë 27.12.2024	384 (300001-00778-80-2025) Regj. Datë 02.06.2025	T.	443		Në proces lidhje kontrate me përmbartuesin E.Shpk

Burimi: Të dhënat e AK

Këto të dhëna janë sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria Juridike, së bashku me regjistrin e çështjeve gjyqësore në proces në Gjykatën e Shkallës së Parë, në Gjykatën Administrative të Apelit në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë. Nga auditimi vlerësohet si problematikë diferenca e konsiderueshme në kohë ndërmjet Vendimit të Autoritetit dhe Urdhërit të Ekzekutimit për disa çështje të mbartura nga vitet e kaluara si dhe fakti që megjithëse është nxjerrë Urdhri i Ekzekutimit ende ka gjopa të cilat nuk janë ekzekutuar si pasojë e sigurimit të padisë apo elementëve të tjerë të trajtimit gjyqësor në të cilat Autoriteti i Konkurrencës është palë.

Për problematikat e mësipërme në kufizimin e aksesit në informacion mban përgjegjësi Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës.

III.2.3. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit nr. 952/1, datë 13.10.2025, i ndryshuar u auditua dokumentacioni si më poshtë:

- Rregullorja e brendshme e miratuar;
- Kod i brendshëm etik;
- Struktura organike e institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi;

- Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
- Strategjia dhe Regjistri i Riskut;
- Raportet e Monitorimit;
- Pyetësi i Vetëvlerësimit dhe shkresa e dërgimit në Ministrinë e Financave.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar në planifikimin dhe përdorimi i burimeve financiare me efikasitet dhe efektshmëri, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësive publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plotë;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga stafi i Autoritetit të Konkurrencës (AK), më poshtë rendisim punën e kryer nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve për vitet 2024-2025.

Referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku u konstatua se:

Strukturat përgjegjëse (NA dhe NZ) të AK-së, kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

- Për periudhën objekt auditimi, institucioni në bazë të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka hartuar projektbuxhetin e vitit 2024 -2026 dhe 2025-2027.

-Me shkresën nr. 261 Prot., datë 26.02.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të AK-së i është dërguar Ministrisë së Financave, brenda afatit të caktuar, “Deklarata, Raporti vjetor dhe Pyetësi i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2024”.

- Me shkresën nr. 217 Prot., datë 27.02.2026, të SP të AK-së i është dërguar Ministrisë së Financave, brenda afatit të caktuar, “Deklarata, Raporti vjetor dhe Pyetësi i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2025”.

Nga auditimi konstatohet se, Raporti Vjetor i cilësisë së gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 2, datë 26.01.2024 “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësiti Publike”.

Referuar nenit 19 të Ligjit nr. 10 296 datë 08.07.2010 titullarët e njësive publike zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet 5 komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësive publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat,

përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikët e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i AK-së në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Referuar të dhënave të plotësuara nga koordinatori i MFK-së, në pyetësorin e vetëvlerësimit rezulton se AK operon mbi bazën e “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” miratuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 563 datë 25.10.2018 dhe “Rregullores së Brendshme për Personelin”, miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 43 datë 08.06.2023, e ndryshuar.

AK ka dhe Kodin Etik, për përcaktimin e rasteve të konfliktit të interesit, si detyrim i neni 23 të Ligjit nr. 9121 datë 27.04.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Kodi Etik përcakton qartë vlerat, parimet dhe rregullat e etikës profesionale, si dhe normat e sjelljes që duhet të respektojnë të gjithë punonjësit e institucionit. Neni 7 me titull “Konflikti i Interesit”, bazohet në dispozitat e Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar parashikon rastet që përbëjnë konflikt interesi për personelin e AK-së.

Rregullorja e Brendshme dhe Kodi Etik, u bëhen të njohura të gjithë punonjësve të institucionit që në momentin e nënshkrimit të kontratës së punës.

Referuar auditimit të rregullores së brendshme konstatohet se kjo rregullore nuk është ndryshuar dhe rishikuar në bazë të ndryshimeve që ka pësuar struktura me Vendimin nr. 25/2024 “Për disa ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 43/2017 Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës”.

Gjithashtu, në Kapitullin IV të rregullores së AK-së, neni 53 “Sanksionet”, përcaktohet fillimi i procedurave disiplinore sipas Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Nga auditimi i dokumentacioni evidentohet se, gjatë viteve 2024-2025 nuk janë marrë masa disiplinore për shkelje të rregullave të etikës.

Sipas formularit Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit bën dy herë në vit vlerësimin e performancës për të gjithë punonjësit sipas shkallëve hierarike dhe strukturës së miratuar. Por grupit të auditimit nuk iu vendosën në dispozicion raste praktike për verifikimin e këtyre vlerësimeve.

AK nuk ka njësi përgjegjëse për sinjalizimin pasi sipas Ligjit nr. 60/216 për “Sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” nuk plotëson kërkesat e nenit 10 për më shumë se 80 të punësuar.

Parimi 2 - Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë, mbikëqyrjen mbi performancën e njësive publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Autoriteti i Konkurrencës është institucion i pavarur dhe nuk ka institucione varësie.

Për vitin 2024-2025 rezulton se AK nuk ka në strukturë njësine e Auditit të Brendshëm, pasi nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 1 (numri i punonjësve në organikë është 49 (i ulët), si dhe nuk ka varësi nga ndonjë organ epror). Bazuar në Ligjin nr.

114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar në nenin 10, pika 1, gërma “b”, përcaktohet se “Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm sipas njëres prej formave të përcaktuara në vijim:...kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm nga njësia e Auditimit të Brendshëm e institucionit epror, ose nga njësia e Auditimit të Brendshëm e një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse. Marrëveshja miratohet paraprakisht nga ministri përgjegjës për financat...”. Autoriteti i Konkurrencës, në përmbushje të këtij detyrimi ligjor ka lidhur marrëveshje për kryerjen e shërbimit të auditit të brendshëm nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nr. 7017 prot (MTM) datë 02.11.2016, me afat nga 01.12.2016 deri më 01.12.2019. Në vijim nuk rezulton të jetë lidhur ndonjë marrëveshje për realizimin e shërbimit të auditit të brendshëm, megjithëse ka një korrespondencë në vijim deri në vitin 2019 me MTM dhe MFE, duke mbetur i pa mbuluar ky shërbim. Shkak për mungesën e auditit të brendshëm sipas metodave alternative është mos veprimi nga strukturat kompetente për mbulimin me shërbim, e cila për nga rëndësia e riskut është e mesme.

-Sipas pyetësorit të vetëvlerësimit nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet mujore dhe vjetore të punës lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve, por grupit të auditimit nuk iu vendosën në dispozicion këto plane. Sipas komunikimit me subjektin, si plan vjetor pune shërben rezoluta e Kuvendit, e cila përcakton detyrat e Autoritetit për vitin pasardhës. Hapja e monitorimit/hetimit sipas ankesave që vijnë në AK përkthehen në plan të përmuajshëm.

Konstatim: Nga auditimi konstatohet se AK nuk ka miratuar një Plan Veprimi të posaçëm për sistemin e kontrollit të brendshëm, si pasojë mungojnë edhe raportimet periodike të monitorimit mbi zbatimin e këtij plani. Gjithashtu nuk është hartuar ndonjë plan veprimi konkret për arritjen e objektivave, veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, pika a.

Gjithashtu konstatohet se titullari i AK-së nuk ka miratuar një plan të veçantë për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë, në mospërputhje me kërkesat e përcaktuara në Aneksin nr. 5 të Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 4 datë 26.01.2024.

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësiave funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit/Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

Referuar të dhënave të plotësuara nga koordinatori i MFK-së në pyetësorin e vetëvlerësimit, rezulton se Misioni dhe Deklarata e Politikës së Programit janë hartuar, miratuar nga titullari i institucionit dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave, si pjesë e dokumentacionit të programit buxhetor afatmesëm.

Struktura organizative dhe organigrama e institucionit është miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 42/2023 datë 15.06.2023 ndryshuar me Vendimin nr. 25/2024.

Nga auditimi konstatohet se në rregulloren e AK-së janë përcaktuar përgjegjësitë e menaxherëve për zbatimin e detyrave të tyre funksionale.

Nga auditimi u konstatua se likuidimi i praktikës për rikthimin e shumës mbi shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 874 datë 25.03.2022 në bazë të Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 127 datë 30.01.2025, është kryer pa miratimin e titullarit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pika 60 ku citohet: “Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësisë administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa miratimin e titullarit.”

Parimi 4 - Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësive.

Referuar të dhënave të plotësuara nga koordinatori i MFK-së në pyetësorin e vetëvlerësimit, rezultoi se, miratimi i strukturës është i shoqëruar me përshtatjet e punës për çdo pozicion. Nga Burimet Njerëzore hartohet plani vjetor i nevojave për planifikimet sipas linjave të raportimit.

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion mbi strukturën organizative të AK, rezultoi se me shkresën nr. 3200/2 prot., datë 04.04.2024 është dërguar nga Kuvendi Vendimi nr. 25/2024 “Për disa ndryshime në vendimin e Kryetarit nr. 43/2014 ‘Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës’, i ndryshuar”. Për vitin 2024-2025 janë miratuar gjithsej 49 pozicione pune. Gjatë vitit 2024 ka pasur 5 vende vakante dhe gjatë vitit 2025 6 vende.

Tabela nr. 15: Struktura organizative (plan/fakt)

Struktura e AK	Plan	Fakt	Vakanca
Viti 2024	49	44	5
Viti 2025	49	43	6

Burimi: Të dhëna të AK-së, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Mungesa të punonjësve në strukturë mund të ndikojnë në mirëfunksionimin e punës si dhe në uljen e performancës së përgjithshme institucionale.

Në lidhje me rekrutimin (punësimin) e punonjësve pranë AK-së.

Organizimi dhe funksionimi për të gjithë stafin e AK-së është rregulluar, ndër të tjera, edhe me rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion, rezultoi se gjatë vitit 2024, në AK janë zhvilluar 3 procedura konkurrimi. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 5 procedura konkurrimi.

Sipas të dhënave janë realizuar trajnime të personelit si brenda dhe jashtë vendit.

Me Urdhrin e brendshëm me shkresën nr. 222/1 prot., datë 13.03.2024, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS)/Ekipi Qendror i Menaxhimit të Programit (EMP). Gjithashtu me Urdhrin e brendshëm me shkresën nr. 15/17 prot., datë 26.03.2025, është ngritur GMS/ EMP për vitin 2025.

Nga auditimi rezultoi se nga AK, konkretisht struktura përgjegjëse e saj, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit nuk janë hartuar plane vjetore trajnimesh të detyrueshme për punonjësit e saj. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, Kreu II, pika 8, Kreu III, neni 20.

Me shkresën nr. 689/1 prot., datë 29.10.2024 është shkresa për kthimin e përgjigjes ndaj Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për vlerësimin e nevojave për trajnim për vitin 2025. -Grupi të auditimit gjatë punës në terren nuk iu vendosën në dispozicion dosje të personelit për të verifikuar saktësinë, plotësinë e mbajtjes së dokumentacionit. Nëpërmjet observacioneve është vënë në dispozicion 1 dosje personeli që i periudhës objekt auditimi, e cila nuk kishte bashkëngjitur formularin e vlerësimit të performancës.

Parimi 5 - Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësiave dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm. Referuar të dhënave të plotësuara nga koordinatori i MFK-së në pyetësonin e vetëvlerësimit, rezulton se, gjatë viteve 2024-2025 në AK nuk ka pasur delegim të kompetencave.

Mungojnë procesverbalet e mbledhjeve të GMS-së që të dokumentojnë diskutimet, analizat dhe vendimmarrjet lidhur me realizimin e detyrave të parashikuara për këtë grup. Kjo situatë tregon mungesë të dokumentimit dhe funksionimit të strukturuar të GMS-së, duke cenuar efektivitetin e mekanizmave të qeverisjes dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm në institucion, veprime këto jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, i ndryshuar, neni 27, pika 1 dhe me Udhëzimin nr. 16 të MFE, datë 20.07.2016 *“Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”* pika nr. 3, paragrafi 2.2.4 *“Roli i GMS në sistemin e MFK”*, së, e cila përcakton se: *“GMS duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit...”*

Vetëm për vitin 2025 janë vënë në dispozicion të grupit të auditimit 2 procesverbale të mbledhjes së GMS-së mbi përgatitjen e kërkesave buxhetore 2026-2028, Faza e parë dhe Faza e dytë.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimi 6 - Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët/NA përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Referuar të dhënave të plotësuara nga koordinatori i riskut, në pyetësonin e vetëvlerësimit, rezulton se gjatë viteve 2024-2025, AK ka hartuar programe afatmesme trevjeçare dhe programe vjetore. Treguesit buxhetorë janë të miratuar me ligj dhe objektivat janë të publikuara.

Parimi 7 - Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

Referuar të dhënave të plotësuara nga koordinatori i riskut në pyetësin e vetëvlerësimit, rezulton se gjatë viteve 2024-2025, AK ka ndërmarrë masa për ngritjen dhe funksionimin e strukturave për menaxhimin e riskut dhe sistemit të kontrollit të brendshëm.

Njësia ka si koordinator risku Sekretarin e Përgjithshëm z. E. Ç. Referuar të dhënave të vetëvlerësimit, koordinatori i riskut ka deklaruar se gjatë viteve 2024-2025 është ngritur Grupi i Menaxhimit të Riskut (GMS), i cili në fillim të vitit ka miratuar metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe se institucioni ka një procedurë të shkruar për menaxhimin dhe kontrollin e riskut, duke përfshirë identifikimin, analizimin, kontrollin e risqeve dhe vlerësimin e riskut të mashtrimit.

Gjithashtu, është raportuar se janë ndërmarrë masa për minimizimin e risqeve të lidhura me mashtrimin dhe korrupsionin, përmes forcimit të rregullave të brendshme, përmirësimit të dokumentacionit dhe trajnimit të stafit.

Megjithatë, gjatë auditimit, nuk janë vënë në dispozicion të grupit të auditimit dokumente justifikuese si urdhri për ngritjen e Grupit të Menaxhimit të Riskut (GMR), planet konkrete të menaxhimit të risqeve, procesverbalet e mbledhjeve të grupit dhe raportet periodike të monitorimit dhe vlerësimit të risqeve.

Konstatim: Nga auditimi konstatohet se Titullari i AK-së nuk ka nxjerrë një urdhër për ngritjen e Grupit të Menaxhimit të Riskut, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër nr. 4, datë 26.01.2024, Kapitulli II pika 2.4.4 dhe Kapitulli III pika 3.2 ku citohet se *“Grupi i Menaxhimit të Riskut të njësisë miratohet nga Titullari si një organ i rëndësishëm monitorimi dhe koordinimi midis linjës së parë dhe të dytë të mbrojtjes. Aktivitetet e monitorimit të kryera nga GMR zakonisht përfshijnë të tre kategoritë e objektivave siç janë objektivat operacionale, të raportimit, të përputhshmërisë.”* Gjithashtu sipas pikës 3.2 *“Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e risqeve kryesore brenda njësisë së tij. Për këtë qëllim ai miraton Grupin e Menaxhimit të Risqeve të njësisë publike, me përfaqësues nga të gjitha strukturat e njësisë që ai mbulon (në varësi të madhësisë së njësisë dhe niveleve të vartësisë). Nëpunësi Autorizues duke qenë përgjegjës për zbatimin e sistemit të MFK-së, në rolin e Koordinatorit për MFK ai është njëkohësisht kryetar i GMR dhe përgjigjet tek Titullari për zbutjen e risqeve brenda njësisë.”*

Nga auditimi konstatohet se Regjistri i Riskut nuk përmban risqe për të gjitha drejtoritë e institucionit si dhe nuk janë hartuar plane të masave për menaxhimin e risqeve, të cilat duhet të përcaktojnë në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin e risqeve (të ashtuquajturit pronarë të risqeve), trajtimin e risqeve në nivel strategjik, programi dhe aktiviteti, si dhe mekanizmat për monitorimin, vlerësimin dhe matjen e risqeve. Kjo situatë paraqet mospërputhje me kërkesat e parashikuara në anekset 4, 5, 6 dhe 7 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Parimi 8 - Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

Referuar të dhënave të vetëvlerësimit, konstatohet se gjatë viteve 2024-2025 nuk ka pasur raste të referuar mashtrimi.

Parimi 9 - Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

Referuar të dhënave të vetëvlerësimit, që në momentin e planifikimit të ndryshimeve ose riorganizimeve merren në konsideratë risqet përse i përket sistemit të kontrollit të brendshëm.

III. Komponenti “Aktivitetet e Kontrollit”

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka “zgjedhje ideale” në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

Referuar të dhënave të plotësuara nga koordinatori i MFK-së në pyetësorin e vetëvlerësimit, rezulton se gjatë periudhës objekt auditimi, zbatohet sistemi i dy firmave për të gjitha transaksionet financiare, përfshirë funksionet e NA dhe NZ. Në institucion është e përcaktuar ndarja e detyrave midis miratimit, ekzekutimit dhe regjistrimit të operacioneve financiare, duke respektuar parimin që personeli zbatues nuk ka të drejtë autorizimi të veprimeve. Për procedurat financiare janë miratuar rregulla të veçanta në përputhje me këtë parim.

Në fushën e prokurimeve, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, të ndryshuar, titullari për çdo procedurë prokurimi, me urdhër të veçantë ka ngritur komisionet për hartimin e specifikimeve teknike, vlerësimin e ofertave dhe pranimin e mallrave, me përbërje prej 3 anëtarësh, ku të paktën njëri është ekspert i fushës përkatëse. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive përkatëse.

Gjithashtu, bazuar në këtë VKM është hartuar dhe miratuar Regjistri vjetor i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, i cili përditësohet gjatë vitit sipas kërkesave dhe ndryshimeve të fondeve.

Në zbatim të dispozitave ligjore për arkivat (Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, i ndryshuar me Ligjin nr. 27/2024, datë 04.04.2024), si dhe rregulloreve të brendshme, AK ka një procedurë të përcaktuar për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit arkivor. Procesi përfshin hartimin e pasqyrës së çeljes së dosjeve arkivore në fillim të çdo viti, ndarjen sipas afateve të ruajtjes dhe përpunimin e dokumentacionit financiar sipas normave të Arkivit Qendror të Shtetit.

Për menaxhimin e aktiveve, AK zbaton Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, të ndryshuar. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit mban Regjistrin analitik të aktiveve.

Me urdhrin e brendshëm nr. 02 datë 13.01.2025 është krijuar komisioni për inventarizimin e inventarit ekonomik dhe mjeteve kryesore dhe me shkresën nr. 199 datë 10.02.2025 është mbajtur

procesverbali i inventarizimit. Gjithashtu me urdhrin e brendshëm nr. 4 datë 16.01.2026 është krijuar komisioni për inventarizimin të vlerave materiale të institucionit.

AK nuk ka procedurë specifike për ruajtjen nga përdorimi i paautorizuar i aktiveve të rëndësishme (me vlera të konsiderueshme).

Për të ardhurat që arkëton institucioni kryhet rakordim mujor me degën e Thesarit Tiranë.

Parimi 11 - Njësia Publike për zgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softwerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

Institucioni përdor sistemet financiare dhe operative AFMIS dhe HRMIS, ndërsa janë marrë masa për mbrojtjen e aktiveve afatgjata dhe të dhënave personale nga akseset dhe ndërhyrjet e paautorizuara, përfshirë instalimin e firewall-it, menaxhimin e fjalëkalimeve dhe kufizimin e aksesit sipas roleve të përdoruesve. Veç sistemeve fikse ka dhe një sistem të veçantë për hedhjen e raporteve hetimore sipas drejtorive dhe ruajtjen e tyre. Për periudhën objekt auditimi institucioni nuk ka operuar me ndonjë sistem financiar të mbajtjes së të dhënave, por vetëm me paketën e microsoft /programin excel, i cili është lehtësisht i modifikueshëm dhe nuk i ruan të dhënat financiare institucionale në formë elektronike, jo në përputhje me pikën 2.4.5, pika g, të Urdhrit nr. 4, datë 26.01.2024 “*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*” në të cilin përcaktohet “dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe transaksioneve të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të njësisë”.

Parimi 12 - Njësia Publike vendos aktivitete kontrolli përmes politikave dhe procedurave.

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

Referuar të dhënave të vetëvlerësimit, konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi në AK janë përcaktuar përgjegjësitë për aktivitetin e kontrollit financiar për drejtuesit dhe gjithë personelin, duke respektuar ndarjen e roleve në mënyrë që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në katër fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar (hartim, miratim, zbatim, monitorim). Këto detyrime janë të përfshira në detyrat kryesore të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit. Ekzistojnë procedura kontrolli për: *a) integritetin e të dhënave financiare, përmes rakordimeve mujore të llogarive (arkë, thesar, bankë), si dhe për rakordimin dhe pastrimin e llogarive pezull dhe të paradhënieve; b) sigurinë e të dhënave financiare, duke përcaktuar qartësisht aksesin për lexim dhe modifikim të të dhënave kontabël; c) ekzistencën e gjurmëve të auditimit për verifikimin e integritetit të të dhënave.*

Nga auditimi evidentohet se pjesa më e madhe e të dhënave/analizave mbahen në format Excel dhe janë evidentuar evidenca jo të plota dhe jo kronologjike të vendimeve me gjoba të Komisionit të Konkurrencës dhe ekzekutimeve të tyre.

Personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare është specialisti i Financës, ndërsa pasqyrat vjetore financiare nënshkruhen nga Drejtori i Financës dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Konstatim: Nga auditimi konstatohet se AK nuk ka përditësuar gjurmët e auditimit në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban

një proces. Kjo situatë paraqet mospërputhje me kërkesat e përcaktuara në Aneksin nr. 3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, lidhur me nevojën për dokumentimin e qartë të hapave të çdo procesi dhe verifikueshmërinë e të dhënave.

Nga auditimi evidentohet se pjesa më e madhe e të dhënave/analizave mbahen në format Excel dhe janë evidentuar evidenca jo të plota dhe jo kronologjike të vendimeve me gjoba të Komisionit të Konkurrencës dhe ekzekutimeve të tyre.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Referuar të dhënave të vetëvlerësimit, konstatohet se në AK ekziston një sistem raportimi mbi realizimin e buxhetit dhe ecurinë e shpenzimeve krahasuar me planifikimet, në total dhe sipas programeve. Titullari i institucionit dhe drejtuesit e programeve informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi këto të dhëna. Njësia përdor sistemin SIFQ dhe HRMIS.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Referuar të dhënave të vetëvlerësimit, konstatohet se janë zbatuar procedura dhe praktika të përcaktuara për informimin e punonjësve mbi ndryshimet ligjore, udhëzimet e reja në përputhje me fushën e tyre të përgjegjësisë. Institucioni përgatit raporte dhe publikime vjetore mbi performancën e tij lidhur me shërbimet, të cilat publikohen rregullisht në faqen zyrtare të internetit të AK-së.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Referuar të dhënave të vetëvlerësimit, konstatohet se të gjithë punonjësit e AK-së janë pajisur me adresa personale zyrtare të e-mailit dhe përdorin komunikimin elektronik për shkëmbimin e informacionit dhe çështjeve të lidhura me punën.

Në institucion funksionojnë struktura të posaçme që monitorojnë dhe analizojnë reagimet dhe kërkesat e qytetarëve, përmes komunikimeve verbale dhe shkresore. Janë miratuar formularë për ankesat publike, me qëllim që të jenë sa më të besueshme, me qëllim përdorimin për realizimin e procedurave të domosdoshme në zbatim të ligjit.

Në faqen zyrtare të internetit të AK-së publikohet rregullisht raportimi statistikor financiar, baza ligjore mbi të cilën funksionon AK, si dhe materiale informuese.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri dhe vetëvlerësimit.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

Referuar të dhënave të vetëvlerësimit, konstatohet se është realizuar procesi i vetëvlerësimit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor*” dhe Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”.

Një nga hallkat kryesore monitoruese për menaxherët e programeve është pikërisht plotësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe shërbimit të Auditimit të Brendshëm performuar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB).

Për vitin 2024-2025 rezulton se AK nuk ka në strukturë, njësinë e Auditit të Brendshëm, pasi nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”.

Konstatim: Nga auditimi konstatohet se AK nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për monitorimin e zbatimit të Planit të Kontrollit të Brendshëm dhe nuk ka një Plan Veprimi të MFK-së për ndjekjen e progresit dhe analizën e shkaqeve të dështimeve në arritjen e objektivave, në mospërputhje me kërkesat e Manualit të MFK-së, kapitulli II.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi. Referuar të dhënave të vetëvlerësimit, konstatohet se në raportin e menaxhimit financiar është pasqyruar puna dhe rezultatet e kontrollit të brendshëm për vitin raportues.

Gjithashtu, për rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), titullari i institucionit ka ndërmarrë masa korrigjuese përmes hartimit të planeve të veprimit dhe ka organizuar programe të veçanta për ndjekjen e zbatimit të tyre.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e mëposhtme

- Ligji nr.10296/2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015; datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar;
- Ligji 9936, datë 06.02.2012 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH*”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 15 datë 20.07.2016 “*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*”;
- Urdhri nr. 4 datë 26.01.2024, i ndryshuar “*Për miratimin e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin*”.

Për problematikën e evidentuar në akt mbajnë përgjegjësi Titullari, z. D. B. me funksion Kryetar i Autoritetit Kontraktor, Nëpunësi Autorizues z. E. C. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, z. Th. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit.

III.2.4. Të tjera

Për kryerjen e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna në subjektin “Autoriteti i Konkurrencës”.

Objekti i verifikimit është verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme me qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna (statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre), koherencën e tyre dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Nga auditimi i ushtruar në Autoritetin e Konkurrencës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” për periudhën **01.01.2021** deri **31.12.2023** trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në **Vendimin nr. 202, datë 14.10.2024**, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën Nr. 506/9 Prot datë 19.11.2024 konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të Ligjit Nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, subjekti me shkresën plani i masave Nr. 311/16 Prot. datë 06.12.2024 dhe me shkresën përcjellëse Nr. 311/17 Prot., datë 06.12.2024, **brenda afatit 20 ditor nga marrja e shkresës ka dërguar planin e masave** sipas të cilës KLSH duhej të vihej në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

- Nga ana e subjektit është dërguar raportimi 6 mujor mbi rekomandimet me shkresën Nr. 495 Prot. datë 20.05.2025 **brenda afatit 6 mujor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **17 rekomandime** gjithsej, nga këto **12** janë masa organizative, **2** janë masa për shpërblim dëmi, **3** janë Masa Disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **12** masa organizative, të cilat janë pranuar **12** dhe zbatuar plotësisht **5**, në proces zbatimi **1**, të zbatuara pjesërisht **4**, të pazbatuara **2**.
 - b) Masa për shpërblim dëmi **2** të cilat rezultojnë të pranuar dhe të zbatuara,
 - c) Masa disiplinore **3**, të cilat rezultojnë të pranuar dhe të zbatuara.
- Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përgatitjen e PBA-ve 2021-2023 rezultoi se:

-Titullari i institucionit për vitin 2021, nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), jo në përputhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar neni 8, pika 8, gërma “b” dhe neni 27, si dhe Manualin e MFK-së, pika 2.2.6.

-Takimet e GMS-së për periudhën objekt auditimi nuk janë të dokumentuara jo në përputhje me Ligjin Nr.10 296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar neni 27 pika 1, neni 16, pikat 2 dhe 3, si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.2.6.

-Kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së PBA 2021-2023, nuk janë diskutuar/trajtuar në mbledhjet e Ekipit të Menaxhimit të Programit jo në përputhje Udhëzimin Nr.7, datë 28.2.2018 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”, pika 2.6.

-Autoriteti i Konkurrencës, si njësi shpenzuese, nuk ka hartuar raporte monitorimi 4-8-12 mujore. Konkretisht: për vitin 2021 nuk është përgatitur dhe dorëzuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raporti 8-mujor; për vitin 2022, nuk është përgatitur dhe dorëzuar raporti 12-mujor dhe për vitin 2023 nuk është dorëzuar raporti 4-mujor dhe raporti 8 mujor, me qëllim ndjekjen e

realizimit të produkteve të buxhetit të saj, garantimin e përmirësimit të procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik, jo në përputhje me Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, neni 65 dhe Udhëzimin Nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të Monitorimit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, kreu II dhe kreu III, pika 3.2, i ndryshuar.

-Raportet e monitorimit, përshkruajnë/pasqyrojnë veprimtarinë e institucionit si dhe të dhëna në terma sasiorë, por nuk bëjnë një analizë mbi ndryshimet e zërave buxhetore për periudhën raportuese, mosarritjet dhe shkaqet e tyre duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës apo mangësitë në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit, jo në përputhje me Udhëzimin Nr.9, datë 20.7.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 267.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Titullari i Autoritetit të Konkurrencës për organizimin dhe dokumentimin e aktivitetit periodik të Grupit të Menaxhimit Strategjik lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

-Të merren masa nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues për monitorimin e zbatimit të Buxhetit të Shtetit duke hartuar raportet e monitorimit të buxhetit çdo katër muaj për Autoritetin e Konkurrencës, si njësi shpenzuese për produktet e buxhetit të administruara nga ana e tij, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Në zbatim në vijimësi sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH, Grupi i Menaxhimit Strategjik, ka marrë masat për organizimin dhe dokumentimin e aktivitetit periodik në funksion të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e rekomandimit.

Gjithashtu Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, kanë siguruar monitorimin e zbatimit të Buxhetit të Shtetit dhe hartimi i raporteve të monitorimit çdo katër muaj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit të Autoritetit.

Komenti i grupit të Auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se nga mbledhjet e Grupit të Menaxhimit Strategjik, rezulton se janë dokumentuar vetëm dy mbledhje, lidhur me masat për organizimin në funksion të menaxhimit financiar dhe kontrollit, sipas kërkesave të rekomandimit. Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues kanë siguruar monitorimin e zbatimit të Buxhetit të Shtetit dhe hartimin e raporteve të monitorimit çdo katër muaj, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit të Autoritetit.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi pasqyrat financiare rezulton se pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore për aktivitetin e AK për vitet 2021, 2022 dhe 2023, nuk janë nënshkruar nga Nëpunësi Zbatues, por nga hartuesi i tyre (specialist pranë Drejtorisë së Financës) duke operuar kështu jo në përputhje me Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar Neni 4, pika 24 si dhe neni 12, pikat 2, germa “b” dhe pika 3, germa “ë” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pika 2.2.8.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Konkurrencës, të merren masa që pasqyrat financiare në kuadrin e dokumentacionit financiar të njësisë, të nënshkruhen nga Nëpunësi Zbatues si nëpunës i

nivelit të lartë menaxhues, përgjegjës për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Rekomandimi është zbatuar. Pasqyrat financiare të njësisë tashmë nënshkruhen nga Nëpunësi Zbatues, në cilësinë e nëpunësit të nivelit të lartë menaxhues, përgjegjës për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Komenti i grupit të Auditimit

Konstatohet se, referuar shkresës Nr.339 Prot, datë 21.03.2025 rezulton se pasqyrat financiare në kuadrin e dokumentacionit financiar të njësisë, janë të nënshkruara nga Nëpunësi Zbatues.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi pasqyrat financiare, Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” e cila për vitin 2023 pasqyrohet në vlerën 9,308,085 lekë rezulton e nënvlerësuar për diferencën prej 120,003 lekë dhe mos kuadruar me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në Pasiv të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, në moszbatim të Udhëzimit Nr.8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar pika 32. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Konkurrencës, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Në mbylljen e pasqyrave vjetore të vitit 2024

Përgjigja e institucionit

Rekomandimi është zbatuar. Nëpunësi Zbatues ka kryer sistemimet përkatëse në kontabilitet, duke rregulluar Llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” dhe llogarinë kundërparti 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Nr.8, datë 09.03.2018, të ndryshuar.

Komenti i grupit të Auditimit

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, shkresa Nr.339 Prot, datë 21.03.2025 konstatohet se nga ana e AK janë bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se regjistri i aktiveve që zotëron subjekti është në trajtën e një dokumenti i mbajtur në programin “Excel” ku janë pasqyruar të dhëna pjesore për aktivet si: përshkrimi i aktivitetit dhe datën e vendosjes në përdorim ndërkohë që nuk janë pasqyruar të dhëna mbi: vlerën e blerjes, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, veprime që janë në kundërshtim me përcaktimet e pikave 26, 27 e 30, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me qëllim ruajtjen e aktiveve dhe

burimeve të tjera kundrejt humbjeve të shkaktuara nga keqadministrimi, si dhe kundrejt parregullsive.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Të merren masa për të ndërtuar dhe përditësuar regjistrin e aktiveve në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër, grupit përkatës brenda llojit, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Rekomandimi është zbatuar. Autoriteti i Konkurrencës ka ndërtuar dhe përditësuar regjistrin e aktiveve në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011, të ndryshuar, duke përfshirë të gjitha elementet përkatëse për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e aktiveve. Regjistri administrohet në format të standardizuar dhe është i plotë, i azhurnuar dhe i verifikueshëm.

Komenti i grupit të Auditimit

Konstatohet se AK ka krijuar regjistrin e aktiveve datë 31.12.2024 duke përfshirë elementet përkatëse për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e aktiveve por nuk janë bërë plotësimet në të gjitha elementet përkatëse.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me zbatimin e kuadrit nënligjor për menaxhimin e aktiveve rezultoi:

1. Procedurat e inventarizimit nuk janë ndjekur plotësisht (*nga proceset e vlerësimit deri në daljen jashtë përdorimit*) si dhe asgjësimi për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër. Nuk ka një evidentim të plotë të situatës së inventarizimit për çdo llogari, arsyetimi i shkaqeve mbi inventarin jashtë funksionit, qëndrimi i titullarit/disponimi mbi mënyrën se si do të procedohet në vijim, etj. në kundërshtim me UMF Nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, pika 104-106.

2. Nga komisionet e ngarkuara me inventarizimin e aktiveve, nuk janë hartuar raporte për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në kundërshtim me UMF Nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, paragrafi Nr. 85/ c.

3. Komisionet e inventarizimit të vlerave aktive dhe detyrimeve të AK-së nuk kanë mbajtur procesverbal me përgjegjësin e materialeve për të fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit, në kundërshtim me Udhëzimit Nr. 30 datë 27/12/2011, i ndryshuar, pika 83 “Përgjegjësitë për inventarizimin”.

4. Komisioni i inventarizimit të vlerave aktive dhe detyrimeve të AK-së, nuk kanë përpiluar një relacion në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve për kushtet fizike të ruajtjes së tyre.

- Nga auditimi i fletëve të inventarit të vlerave aktive dhe detyrimeve të AK-së, rezultoi se këto fletë kanë të plotësuar vetëm rezultatin e dalë nga inventarizimi dhe nuk është respektuar proceduara e inventarizimit por është mjaftuar duke marrë të dhënat nga kontabiliteti pa dalë në një konkluzion në lidhje me gjendjen reale të inventarit, pas përlllogaritjes si të amortizimit ashtu dhe mungesave, tepricave të aktiveve, në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30 datë 27/12/2011 i ndryshuar, pika 73 dhe 85.

5. Vlerësimi i Aktiveve nuk është bërë në përputhje me përcaktimet e pikës 103 e në vijim, të UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 20-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i Autoritetit të Konkurrencës/Sekretari i Përgjithshëm për plotësimin dhe dokumentimin e praktikave të inventarizimit në zbatim të UMF Nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar.

-Të merren masa nga Autoriteti i Konkurrencës/ Nëpunësi Autorizues për ngritjen e komisioneve të cilat të jenë funksionale në ushtrimin e kontrolleve për menaxhimin e pasurisë, me qëllim sigurimin e informatave të drejta dhe të sakta për pasurinë që posedojnë.

- Nga strukturat drejtuese të AK-së të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, duhet të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, duke e dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Në zbatim në vijimësi sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Komenti i grupit të Auditimit

Referuar dokumentacionit, shkresa Nr.199/1 Prot., datë 10.02.2025 me Urdhër i Brendshëm Nr.2, datë 13.01.2025 “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale të institucionit” janë marrë masa nga titullari i Autoritetit të Konkurrencës/Sekretari i Përgjithshëm për plotësimin dhe dokumentimin e praktikave të inventarizimit në zbatim të UMF Nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e aktiveve rezultoi:

-Për vitet 2022 -2023 janë parashikuar dhe propozuar për të nxjerrë nga përdorimi aktive me vlerë totale 3,196,058 lekë (respektivisht v.2022 propozuar 9 artikuj me vlerë 490,232 lekë, v.2023 propozuar 27 artikuj me vlerë 2,705,826 lekë), për të cilat mungon gjurma e nxjerrjes nga përdorimi dhe asgjësimit të tyre, në kundërshtim me UMF Nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 109.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Autoriteti i Konkurrencës të vlerësojë dhe të analizojë vlerën prej 3,196,058 lekë propozuar për tu nxjerrë nga përdorimi, e cila rezulton pa dokumentacion justifikues ku të përcaktohen shkaqet, arsyet, përgjegjësitë ligjore dhe financiare.

-Të analizohen rezultatet e grupeve të inventarizimit për të formalizuar procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; listën e aktiveve të identifikuara dhe kriteret për vlerësim, procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve në referencë UMF Nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

-Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës të detajuar mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit

Në zbatim në vijimësi sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Komenti i grupit të Auditimit

Nga AK nuk është paraqitur dokumentacion ku të jetë kryer vlerësimi dhe analizimi i vlerës prej 3,196,058 lekë propozuar për tu nxjerrë nga përdorimi, e cila rezulton pa dokumentacion justifikues ku të përcaktohen shkaqet, arsyet, përgjegjësitë ligjore dhe financiare.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të kryera përmes bankës për vitin 2021-2023, lidhur me procedurat e prokurimit “*blerje me vlerë të vogël*” dhe “*sistem dinamik blerje bileta avioni*”, rezultoi se:

-procedura “*Blerje kuti dhe dosje për arkivim dokumentacioni*” v.2021, lekë nuk është hedhur në SPE, jo në përputhje me Ligjin 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, neni 56;

-në 2 procedura “*Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluar IT e të tjera*” dhe “*Shërbim infrastrukturor për komunikimin on line*” v.2021, kriteret e veçanta nuk janë argumentuar teknikisht, në kundërshtim me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, neni 7 dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, neni 41, pika 2.

- Në 2 raste, procedurat e prokurimit “*Karburant*”, v.2021 dhe v. 2022 nuk është përcaktuar marzhi i fitimit por është operuar me çmim fiks të përcaktuar si kriter vlerësimi në kundërshtim me VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, neni 31, pika 3 dhe VKM Nr. 258, datë 19.05.2021, i ndryshuar neni 45 pika 2,që përcakton elementët përbërës të çmimit.

-në 2 raste “*Blerje materiale Kancelarie dhe Toner*” viti 2022-2023, specifikimet teknike përfshijnë markën në kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 36.

-në 1 rast “*Pjesëmarrje në aktivitetin Dita Ndërkombëtare e Konkurrencës*” v.2022, nuk argumentohet metoda e përzgjedhur për përllogaritjen e vlerës së prokurimit, jo në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 për “*Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, neni 76.

- në shumicën e rasteve të testuara nga auditimi për vitet 2022-2023, në procedurat sistem dinamik blerje bileta avioni, në ftesën për ofertë vendoset kriteri “*eksperiencë në treg prej 10 vite. ... si dhe të ketë në stafin e tij jo më pak se 5 punonjës nga të cilët 3 të jenë të pajisur me Certifikata IATA*”, i cili kufizon pjesëmarrjen e biznesit të mesëm dhe të vogël, jo në përputhje me Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020, i ndryshuar, neni 2, 3 dhe 36, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 41.

-në shumicën e rasteve të testuara nga auditimi për vitet 2022-2023 sistem dinamik blerje bileta avioni, afati realizimit të procedurës është brenda një kohe të shkurtër me datën e udhëtimit, pasi procedurat fillojnë me vonesë nga momenti i dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në event (jashtë vendit), duke sjellë si pasojë, riskun e përzgjedhjes së çmimit me të lartë, jo në përputhje me Ligjin Nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm*”, i ndryshuar neni 8, pika 1, neni 9, pika 1 dhe neni 12, pika 3, germa a.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 39-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i AK që në të ardhmen kriteret e veçanta për kualifikim të jenë në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me objektin që prokurohet. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë.

-Procedurat e prokurimit “Blerje karburanti” të cilat bazohen në ofertën ekonomikisht më të favorshme, çmimi të përlllogaritet bazuar në kriteret e përcaktuara në VKM Nr.258, datë 19.05.2021, neni 45 i ndryshuar.

-Hartimi i dokumentacionit paraprak për fillimin e procedurës së prokurimit me sistem dinamik blerje bileta avioni të përgatitet nga momenti i ardhjes së ftesës për pjesëmarrje në event, me qëllim minimizimin e riskut për rritjen e kostos së blerjes së biletave me çmim më të lartë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Në zbatim në vijimësi sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Komenti i grupit të Auditimit

Konstatohet se nga procedurat e përzgjedhura shkresa Nr.192 Prot., datë 21.02.2024 “Specifikimet teknike dhe përlllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt blerje materiale kancelarie dhe tonera për nevoja të AK-së për vitin 2024” dhe shkresa Nr.192/2 Prot., datë 22.02.2024 “Procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” rezulton se nga ana e AK kriteret e veçanta për kualifikim janë në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me objektin që prokurohet dhe nuk përmenden markë prodhimi apo burim specifik, apo proces i vecantë. Referuar procedurës së prokurimit “Blerje karburanti” të cilat bazohen në ofertën ekonomikisht më të favorshme, çmimi nuk është përlllogaritur bazuar në kriteret e përcaktuara në VKM Nr.258, datë 19.05.2021, neni 45 i ndryshuar.

Referuar shkresës Nr.712 prot, datë 29.10.2024 Urdhër prokurimi nr.59, datë 29.10.2024 dhe shkresës Nr.612 Prot., datë 12.09.2024 Urdhër Prokurimi Nr.52, datë 12.09.2024 hartimi i dokumentacionit paraprak për fillimin e procedurës së prokurimit me sistem dinamik blerje bileta avioni është përgatitur nga momenti i ardhjes së ftesës për pjesëmarrje në event, me qëllim minimizimin e riskut për rritjen e kostos së blerjes së biletave me çmim më të lartë.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të kryera përmes bankës për vitin 2021-2023 rezultojë se, administrimi i dokumenteve justifikuese bashkëlidhur urdhër shpenzimeve mbi bazën e të cilave kryhen pagesa, në disa raste përshkruhet në kolonën përkatëse të urdhër shpenzimit, por nuk administrohej fizikisht bashkëlidhur praktikës dhe në disa raste të tjera dokumentacioni justifikues as nuk përshkruhet në urdhër shpenzim dhe as nuk administrohej, jo në përputhje me Udhëzimin e MF Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar.

-Në 2 raste “Shërbime riparim dere” dhe “Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit”, rezultoi mungesë e argumentimit të nevojës për kryerjen e shërbimit, jo në përputhje me UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pika 54.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 39-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Të merren masa nga AK, që në të ardhmen dokumentacioni justifikues që shoqëron urdhër shpenzimet, të përshkruhet në kolonën përkatëse të urdhër shpenzimit si dhe ti bashkëngjitet atij.

-Planifikimi i nevojave të argumentohet dhe dokumentohet bazuar në kërkesat reale të përcjellë nga sektorët përkatës shoqëruar me analizën e nevojave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Në zbatim në vijimësi sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Komenti i grupit të Auditimit

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion janë parë disa urdhër shpenzime të cilat kanë të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues që shoqëron urdhër shpenzimet dhe përshkrimin në kolonën përkatëse të urdhër shpenzimit.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën 2021-2023, rezultoi se regjistri i realizimeve për prokurimet publike nuk pasqyron të dhëna të plota në lidhje me realizimin e procedurave të prokurimit me vlerë nën 100,000 lekë, jo në përputhje me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 11, pika 3, paragrafi 1, pasi pasqyron vetëm realizimin e procedurave që gjeneron sistemi elektronik i prokurimeve deri te procedurat me blerje të vogël. Prokurimi i blerjeve nën 100,000 lekë dhe pse nuk i nënshtrohen prokurimit, planifikimi i tyre dhe vlerat përkatëse, duhet të pasqyrohen në regjistrin e parashikimeve dhe të realizimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Të merren masa në të ardhmen që realizimi i prokurimeve blerje me vlerë nën 100,000 të pasqyrohet në regjistrin e realizimeve për prokurimet publike, me qëllim pasqyrimin e saktë të të dhënave mbi realizimin e tyre.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Zbatuar

Komenti i grupit të Auditimit

Konstatohet nga shqyrtimi i dokumentacionit se nga ana e AK janë marrë masa që realizimi i prokurimeve blerje me vlerë nën 100,000 të pasqyrohet në regjistrin e realizimeve për prokurimet publike, me qëllim pasqyrimin e saktë të të dhënave mbi realizimin e tyre.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik viti 2023, rezultoi se në procedurat e prokurimit “Blerje pajisje zyrash dhe informatike për nevojat e AK” dhe “Blerje autoveture e re për nevojat e AK” nuk janë mbajtur në konsideratë kriteret të thjeshtuara pranimi për kriterin “Kapasitetin ekonomik dhe financiar”, jo në përputhje me VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar neni 55, pika 5, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, pasi AK ka zgjedhur si procedurë prokurimi në dy rastet “Tender të Hapur të Thjeshtuar”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Autoriteti i Konkurrencës që në të ardhmen në procedurat e prokurimit të llojit “Tender i Hapur i Thjeshtuar”, të merren në konsideratë kriteret të thjeshtuara pranimi në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Zbatuar

Komenti i grupit të Auditimit

Referuar dokumentacionit, në procedurat e përzgjedhura të prokurimit të llojit “Tender i Hapur i Thjeshtuar” shkresa Nr.284/3 Prot, datë 27.03.2025 Relacion për hartimin e nevojave,

specifikimeve teknike, kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetin teknik, hartimin e kriterëve, grafikun e lëvrimit dhe fondin limit për procedurën e prokurimit “Blerje pajisje informatike për AK-në”, si dhe shkresa Nr.284/6 Prot, datë 28.04.2025 “Procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” janë marrë në konsideratë kriterë të thjeshtuara pranimi në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi strukturën organike për vitin 2021-2023 rezulton se Autoriteti i Konkurrencës nuk ka njësinë e Auditit të Brendshëm, pasi nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për Miratimin e Kriterëve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”, pika 1 (numri i punonjësve në organikë është 49 (i ulët), si dhe nuk ka varësi nga ndonjë organ epror).

Bazuar në Ligjin Nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar në nenin 10, pika 1, germa “b”, AK ka lidhur marrëveshje për kryerjen e shërbimit të auditit të brendshëm nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Nr.7017 prot (MTM) datë 02.11.2016, me afat nga 01.12.2016 deri me 01.12. 2019. Në vijim nuk rezulton të jetë lidhur ndonjë marrëveshje për realizimin e shërbimit të auditit të brendshëm, megjithëse ka një korrespondencë në vijim deri në vitin 2019 me MTM dhe MFE, duke mbetur i pa mbuluar ky shërbim.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Autoriteti i Konkurrencës të marrë masa për të siguruar realizimin e shërbimit të auditimit me një njësi Auditimi të Brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje mes titullarëve të institucionit me qëllim përmbushjen e kërkesave të Ligjit Nr.114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar dhe VKM Nr.83 datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”, i ndryshuar.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Është ngritur si shqetësim në komisionet parlamentare gjatë raportimeve. Në të ardhmen, me marrjen e ambienteve të reja(pasi aktualisht nuk arrijmë dot të akomodojmë as organikën që kemi), do të kërkojmë buxhet për krijimin e njësisë së auditimit të brendshëm.

Komenti i grupit të Auditimit

Konstatohet se nga ana e Autoritetit të Konkurrencës nuk janë marrë masa për të siguruar realizimin e shërbimit të auditimit me një njësi Auditimi të Brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje mes titullarëve të institucionit me qëllim përmbushjen e kërkesave të Ligjit Nr.114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar dhe VKM Nr.83 datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*”, i ndryshuar.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi strukturën organike për vitin 2021-2023 rezulton se Autoriteti i Konkurrencës nuk ka krijuar “*bazën e të dhënave gjyqësore*” për shlyerjen e detyrimeve monetare që rrjedh nga vendimet gjyqësore të formës së prerë për gjyqëfituesit e larguar nga puna, si dhe nuk ka ngritur Komisionin e Posaçëm, me qëllim uljen e riskut dhe koston shtesë të pagesave të vonuara për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, për punonjësit e larguar nga puna, që janë jo në përputhje me Urdhrin Nr.5151, datë 28.10.2015 e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe

Administratën Publike, Kreu II, pika 1 dhe Kreu IV, pika 1, pasi AK në kuptim të pikës 3 të këtij urdhri, si njësi publike në cilësinë e “njësisë debitoare” mbart një detyrim të caktuar sipas një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 35-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i institucionit që nga Sektori i Burimeve Njerëzore të krijohet “baza e të dhënave gjyqësore” për shlyerjen e detyrimeve monetare për gjyqëfituesit e larguar nga puna, me qëllim uljen e riskut dhe koston shtesë të pagesave të vonuara për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Në zbatim në vijimësi sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Komenti i grupit të Auditimit

AK ka krijuar dokumentin “baza e të dhënave gjyqësore” për shlyerjen e detyrimeve monetare për gjyqëfituesit e larguar nga puna, me qëllim uljen e riskut dhe koston shtesë të pagesave të vonuara për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit i ndryshuar, neni 15, germa ”b” dhe “c” si dhe Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 98 e vijues, i rekomandohet titullarit të Autoritetit të Konkurrencës të nxjerrë aktin administrativ për kërkimin e dëmit shkaktuar buxhetit në vlerën totale **93,616 lekë** me TVSH referuar gjetjeve si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik viti 2023, rezultoi se në procedurën “Blerje autoveture e re për nevojat e AK”, në zbatim të Kontratës Nr.255/10, datë 15.06.2023 është likuiduar OE fitues “A.” me Urdhër Shpenzimin Nr.267, datë 10.11.2023 në vlerën 3,500,000 lekë me TVSH. Bazuar në ofertën e paraqitur nga operatori, vlera e saj rezulton 2,900,000 lekë pa TVSH/3,480,000 lekë me TVSH. Nga mbartja e gabimeve materiale në vlerë që nga aktet e KVO mbi vlerësimin e ofertës deri në lidhjen e kontratës, është krijuar dëm për buxhetin e AK në vlerën 20,000 lekë përfituar padrejtësisht nga OE fitues.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i Autoritetit të Konkurrencës të nxjerrë aktin administrativ për kërkimin e dëmit shkaktuar buxhetit të AK në vlerën **20,000 lekë** përfituar padrejtësisht nga OE “A.”, duke ndjekur gjyqësisht kthimin e tij në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit

Zbatuar. Derdhur në buxhet shteti dhe shënuar si “të ardhura të tjera (akt detyrim kthimi nga KLSH)”.

Komenti i grupit të Auditimit

Nga auditimi mbi dokumentacionin, nga ana e Titullarit të Autoritetit të Konkurrencës janë marrë masa për nxjerrjen e aktit administrativ për ndjekjen në rrugë gjyqësore për kërkimin e dëmit si dhe është bërë arkëtimi i vlerës në buxhetin e shtetit.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të kryera me sistem dinamik blerje bileta avioni rezultoi se:

-Me Urdhër Shpenzimin Nr.45, datë 09.03.2022 është likuiduar OE F. SHPK, me vlerë 74,221 lekë ose 73,616 lekë më shumë se oferta e paraqitur (oferta e paraqitur në SPE është shprehur në vlerën 605, që nënkupton monedhën në lekë, pasi sistemi gjeneron vlerat në lekë dhe jo në monedhë të huaj). Fatura elektronike e sjellë nga OE rezultoi në vlerën 74,221 lekë dhe është nënshkruar edhe nga Komisioni, ndërkohë që procesverbali i vlerësimit nga Komisioni është nënshkruar për ofertën në vlerën 605 lekë paraqitur nga OE F. SHPK, duke shkaktuar dëm për buxhetin e AK në vlerën **73,616 lekë**, përfituar padrejtësisht nga OE F. SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 39-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i Autoritetit të Konkurrencës të nxjerrë aktin administrativ për kërkimin e dëmit shkaktuar buxhetit të AK në vlerën 73,616 lekë përfituar padrejtësisht nga OE “F”, duke ndjekur gjyqësisht kthimin e tij në të gjitha shkallët e gjykimit.
Menjëherë

Përgjigja e institucionit

AK ka cuar çështjen në Gjykatën Administrative të Shkallës të Parë, çështja është në proces gjykim, seanca e radhës është në datën 24.03.2026.

Komenti i grupit të Auditimit

Konstatohet nga dokumentacioni se nga ana e Titullarit të Autoritetit të Konkurrencës janë marrë masa për nxjerrjen e aktit administrativ për ndjekjen në rrugë gjyqësore për kërkimin e dëmit shkaktuar buxhetit të shtetit.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

C. MASA DISIPLINORE

C.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germen (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM Nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” **i rekomandohet** Titullarit të institucionit, që nëpërmjet një grupi pune, të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të cituara më poshtë, sipas përgjegjësisë individuale të nisë procedurat për dhënien e masave disiplinore sipas shkallës nga “vërejtje” deri në “largim”, për punonjësit si më poshtë:

1. Znj. P. Gj., në cilësinë e anëtarit të Komisionit për procedurën blerje bileta avioni sistem dinamik blerje, si dhe në cilësinë e anëtarit në procesin e nxjerrës jashtë përdorimit,

2. Znj. V. V., në cilësinë e anëtarit të Komisionit për procedurën blerje bileta avioni,

3. Z. B. Ll., në cilësinë e anëtarit të Komisionit për asgjësimin e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit,

-për parregullsitë e konstatuara në procedurën “Tiranë-Vienë-New York; New York-Mynih-Tiranë” (copë një); në pranimin e ofertës së OE F. SHPK, ku nga mos korrigjimi i gabimeve materiale në ofertën e paraqitur, ka sjellë si pasojë likuidimin e operatorit në vlerën 73,616 lekë më shumë,

-për parregullsitë e konstatuara në procedurën për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve dhe asgjësimin e tyre, pasi nuk është hartuar proces verbali ku përshkruhet procedura e ndjekur për

nxjerrjen jashtë përdorimit (*duke ndryshuar formën e tyre fillestare/groposur ose djegur*), në kundërshtim me Udhëzimin e MF Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 110, rekomandohet masë disiplinore ndaj tyre dhe pse niveli i materialitetit nuk është i konsiderueshëm dhe gabimet nuk janë në përsëritje.

Përgjigja e institucionit

Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH, AK nxori Urdhërin Nr. 1, datë 08.01.2025, Nr. 12 Prot. datë 08.01.2025 “Për shqyrtimin e çështjeve të lëna në raportin përfundimtar të KLSH”. Në përfundim, grupi i punës adresoi problematikën në fjalë me relacionin 12/1 datë 31.01.2025.

Komenti i grupit të Auditimit

Referuar dokumentacionit, shkresës Relacion Nr.12/1 Prot datë 31.01.2025 si dhe Urdhër Nr.1 datë 08.01.2025 është ngritur Grupi i Punës për vlerësimin dhe shqyrtimin e shkeljeve për të cilat janë propozuar masat disiplinore nga KLSH. Në përfundim është urdhëruar fillimi i procedurave për rimbursimin e dëmit dhe marrjen e masave për respektimin e procedurës.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

Nga subjekti i audituar janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr. 952/9 datë 28.05.2026 në të cilën është parashtruar që:

Pretendimi i subjektit:Jemi njohur me përmbajtjen e materialit të projekt-raportit, me argumentimin tuaj dhe në mënyrë të veçantë me rekomandimet e dhëna, të ndara në masa organizative dhe masa për shpërblim dëmi, me qëllim përmirësimin e gjendjes. Autoriteti i Konkurrencës do të vijojë menjëherë me marrjen e masave sipas rekomandimeve tuaja dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore në fuqi. Komenti i vetëm nga ana jonë lidhet me masën shpërblim dëmi në lidhje me pagesën e plotë të tarifës përmbartimore për të cilën kemi vepruar mbi bazën ligjore të argumentuar në observacionet tona në lidhje me Akt-Konstatimin nr.1. Megjithatë, për këtë çështje kemi drejtuar një shkresë për interpretim pranë Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Privatë dhe kemi vënë në dijeni edhe Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim sigurimin e një interpretimi të saktë dhe adresimin e këtij boshllëku që mund të lejojë hapësirë për interpretime të ndryshme...Sa më sipër, në përmbushje të rekomandimeve të lëna nga ana juaj, Autoriteti i Konkurrencës do të ndërmarrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për kthimin e shumës sipas rekomandimit përkatës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me observacionin e trajtuar më sipër, Autoriteti i Konkurrencës ka rënë dakord me konstatimet dhe rekomandimet sipas përmbajtjes së Projekt Raportit të Auditimit dhe observacioni nuk përmban elementë për tu marrë në konsideratë përtej atyre të trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit.

IV. REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Autoritetit të Konkurrencës për periudhën në auditim u konstatuan problematika në procesin e përgatitjes së PBA, në shpenzimin e fondeve të miratuara dhe kryerjen e procesit të monitorimit si më poshtë:

-Megjithëse janë ngritur GMS nuk rezulton të jetë dokumentuar aktiviteti i tij në drejtim të kërkesave të legjislacionit për planifikimin e buxhetit, pasi nuk ka procesverbale të mbledhjeve të realizuara dhe dokumentacion në lidhje me vendimet e marra, përveç dy procesverbaleve të vitit 2025 për përgatitjen e kërkesave buxhetore të PBA 2026-2028. Në formularët standardë për kërkesat shtesë, është paraqitur e gjithë shumta e kërkuar vjetore, pa vendosur vetëm kërkesat shtesë sipas përcaktimeve të UMF nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*". Nga auditimi konstatohen diferenca të ndjeshme ndërmjet fondeve buxhetore të kërkuara në fazën e parë dhe të dytë të PBA sipas taveve me fondet e miratuara në fazën e tretë të PBA 2024-2026. Këto diferenca konstatohen kryesisht për shkak të parashikimit në nivelin e fondeve për shpenzimet e personelit, përkatësisht në llogarinë e pagave dhe llogarinë e kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Nga auditimi u konstatua se në planifikim nuk janë marrë parasysh efektet e rritjes së pagave në sektorin publik sipas VKM-ve respektive në muajin Prill 2023 me efekte në vitet e ardhshme buxhetore. Kjo problematikë ka sjellë situatën e nevojës së detyruar për rritjen e fondeve në fazën e tretë të PBA, megjithëse efekti i rritjes duhej të ishte pasqyruar që në fazën e dytë të PBA 2024-2026 dhe të refleктоhej në tavanet përkatës buxhetorë.

-Në realizimin e buxhetit, referuar planit fillestar dhe atij përfundimtar konstatohen diferenca në zërin e shpenzimeve korrente përse i përket shpenzimeve operative, zërit 602 dhe transfertave drejt të tretëve. Nga auditimi u konstatua se buxheti i vitit 2024 rezulton të mos jetë realizuar për shumën 10,385 mijë lekë, me mos realizim më të madh në zërin e pagave në shumën 6,573 mijë lekë dhe zërin e shpenzimeve operative në shumën 2,785 mijë lekë. Megjithëse në planifikimin fillestar është kërkuar më shumë buxhet se ai i miratuar për shpenzimet operative, u konstatua se nuk është realizuar buxheti me rreth 28% të planit përfundimtar për artikullin 602.

- Shpenzimet për investime janë miratuar në shumën 10,000 mijë lekë për vitin 2025, ku me shkresën nr. 271 datë 03.03.2025 është kthyer përgjigje kërkesës së Ministrisë së Financave nr. 17548 datë 23.12.2024 për detajimin e planit të buxhetit për periudhën 2025-2027. Bashkëlidhur kësaj shkrese janë dërguar shtojca 2 (F-2) për projektet e investimit të vitit 2025. Nga auditimi u konstatua se procesi i detajimit të investimeve publike për Autoritetin e Konkurrencës ka zgjatur më shumë se dy muaj nga kërkesa e Ministrisë së Financave dhe formularët e investimeve janë dërguar vetëm pas kësaj shkrese, jo që në fillim të procesit të planifikimit. Nuk ka argumentim në lidhje me zgjatjen e afateve për detajimin e investimeve publike, megjithëse informimi mbi nivelin e fondeve të investimeve është kryer që në muajin dhjetor 2024. Gjithashtu shtojca 2 është dërguar vetëm pasi janë miratuar fondet e investimeve dhe jo në momentin e dërgimit të kërkesës për fonde buxhetore, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në udhëzimin standard për përgatitjen e buxhetit dhe VKM për procedurat e menaxhimit të investimeve publike.

-Raportet e monitorimit të buxhetit të dërguara në Ministrinë e Financave u konstatua se kanë të bashkëngjitur anekset e përcaktuara në udhëzimin për hartimin e tij si dhe një analizë të

shpenzimeve buxhetore të realizuara, megjithatë u konstatua se nuk ka një analizë të veprimtarisë së institucionit përse i përket të ardhurave të realizuara apo një analizë të hollësishme mbi mosrealizimet e shpenzimeve. Nga auditimi mbi monitorimin e buxhetit të Autoritetit të Konkurrencës u konstatua se raportet e monitorimit të hartuara nga institucioni përgjithësisht nuk kanë një analizë të hollësishme mbi treguesit kryesorë të buxhetit, duke qenë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 14 datë 30.05.2023 të MF “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, pika 4, 5 dhe 49.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 10-20 të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës të merren masa në drejtim të menaxhimit të buxhetit sipas drejtimeve të mëposhtme:

- përmirësimin e procesit të planifikimit duke dokumentuar aktivitetet e GMS, plotësimin e formularëve të projekteve të investimeve përpara kërkesës për fonde të investimeve dhe përfshirjen e të gjithë fondeve të nevojshme në ndryshim të legjislacionit që shkakton kërkesa buxhetore shtesë për buxhetin e Autoritetit të Konkurrencës.

- analizimin e shmangieve të faktit të buxhetit nga plani i miratuar fillestar dhe ai i ndryshuar nëpërmjet marrjes së masave përkatëse dhe reflektimin në buxhetin e vitit pasardhës.

- hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit nëpërmjet lidhjes së treguesve financiarë me ato jo financiarë sipas formatit standard për kryerjen e monitorimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listës së vendimeve të Komisionit të Konkurrencës në AK u konstatua se nuk ka një proces monitorimi në vazhdimësi për ato vendime të cilat kanë rezultuar me rekomandime apo kërkesa drejtuar ndërmarrjeve/autoriteteve publike referuar fushës së veprimtarisë së AK. Mungesa e një sistemi monitorimi të vazhdueshëm, në formën e një mekanizimi të ndjekjes nëpërmjet inspektimeve tematike apo detyrimeve për raportim, bën të pamundur vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës. Ndjekja dhe kontrolli i zbatimit të vendimeve është në fushën e përgjegjësisë së Autoritetit të Konkurrencës nëpërmjet Sekretariatit. Këto veprime rezultojnë në kundërshtim me nenin 28 “Përgjegjësitë e Sekretariatit” të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar si dhe me Rregulloren e brendshme të AK “Për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës”, e miratuar me Vendimin nr. 563 datë 25.10.2018, neni 31 dhe 32.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 20-24 të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit të Konkurrencës në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të marrin masa për të hartuar dhe zbatuar një mekanizëm të qëndrueshëm monitorimi për ndjekjen e zbatimit të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, veçanërisht për ato që përmbajnë rekomandime apo detyrime ndaj ndërmarrjeve dhe autoriteteve publike. Të merren masa për krijimin e një sistemi evidencash dhe raportimi të brendshëm për të matur nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe efektivitetin e vendimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës u konstatua se nuk ka pasur një ndjekje në kohë reale të vendimeve për ekzekutimin e gjobave, duke qenë se mungojnë të dhëna të gjobave përpara vitit 2021. Gjithashtu evidentohet se nuk ka koherencë të vendimeve gjyqësore të pasqyruara në listën e ekzekutimeve në ndjekje nga viti në vit. Ekzekutimet e vendimeve gjyqësore nuk janë të pasqyruara në pasqyrat financiare të AK në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe

raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". Referuar procedurës së ndjekur për arkëtimin e të ardhurave, u konstatua se nga financa nuk kontabilizohen debitorët që krijojnë vendimet e Autoritetit të Konkurrencës, veprim jo në përputhje me Udhëzimin nr. 08 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 05 datë 21.02.2022. Nga Drejtoria e Financës mbahen evidenca vetëm mbi arkëtimet që kryhen përgjatë vitit pas njoftimit nga strukturat e thesarit. Vendimet e Komisionit dërgohen për ndjekje në Drejtorinë Juridike, Integritet dhe Çështjeve Gjyqësore dhe nga auditimi u konstatua se nuk ka një procedurë rakordimi ndërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit (DBNJBK) dhe Drejtorisë Juridike për arkëtimet e kryera në fund të periudhave raportuese përkatëse. Gjatë auditimit janë kërkuar të dhënat analitike të të ardhurave të realizuara, të cilat janë përcjellë vetëm për arkëtimet e kryera për të ardhurat nga gjoba dhe jo për të ardhurat nga përqëndrimet dhe autorizimet, me argumentin se ato ndiqen nga Drejtoria e Përqëndrimeve. Nga auditimi u konstatua se procesi i arkëtimin të të ardhurave nga përqëndrimet nuk kryhet i administruar nga DBNJBK pasi mungon gjurma dokumentare dhe të dhënat analitike në regjistra mbi arkëtimet e kryera në bazë të faturave për arkëtim, të cilat duhet të jenë me rend kronologjik për të bërë të mundur konstatimin e të ardhurës rast pas rasti dhe më pas arkëtimin e saj. Nuk ka konsolidim të praktikave ndërmjet drejtorisë juridike dhe financës me njohjen e debitorëve në kontabilitet menjëherë pas daljes së vendimit administrativ. Këto konstatime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në rubrikën 2.3 "Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit", paragrafi 16 dhe 21 të Udhëzimit nr. 08 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 05 datë 21.02.2022.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1 dhe III.2.2, faqe 10-24 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike, Integritet dhe Çështjeve Gjyqësore së bashku me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit të marrin masa për krijimin dhe zbatimin e një sistemi të integruar dhe në kohë reale për administrimin, ndjekjen dhe raportimin e gjobave të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës, me qëllim sigurimin e plotësisë, saktësisë dhe transparencës së të dhënave. Të krijohet një regjistër i unifikuar elektronik për të gjitha gjobat, duke përfshirë edhe ato përpara vitit 2021, me të dhëna të plota mbi statusin e tyre si dhe të garantohet pasqyrimi i plotë dhe i saktë i ekzekutimeve të gjobave në pasqyrat financiare dhe në të njëjtën kohë të kontabilizohen të gjitha të ardhurat e realizuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (MFK) u konstatuan disa problematika në lidhje me pesë komponentët si vijon:

1.1. Referuar komponentit "Mjedisi i kontrollit" nga auditimi u konstatua se:

- Rregullorja e Brendshme e miratuar me Vendimin nr. 563 datë 25.10.2018 nuk është ndryshuar dhe rishikuar në bazë të ndryshimeve që ka pësuar struktura me Vendimin e Kuvendit nr. 25/2024.
- Për vitet 2024-2025, AK nuk ka në strukturë njësinë e Auditimit të Brendshëm, pasi nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", pika 1. Në vijim nuk rezulton të jetë lidhur ndonjë marrëveshje me njësi të tjera publike për realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar në nenin 10, pika 1, gërma "b".

- Grupit të auditimit nuk iu vendosën në dispozicion: raste praktike për verifikimin e vlerësimeve periodike të kryera nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit (DBNJBK); planet vjetore dhe mujore të punës lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve.

- Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion mbi strukturën organizative të AK, rezultoi se për vitet 2024-2025 janë miratuar gjithsej 49 pozicione pune, ku gjatë vitit 2024 ka pasur 5 vende vakante dhe gjatë vitit 2025 6 vende vakante. Mungesa të punonjësve në strukturë mund të ndikojnë në mirëfunksionimin e punës si dhe në uljen e performancës së përgjithshme institucionale.

- Titullari i AK-së nuk ka miratuar një plan të veçantë për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë, në kundërshtim me Aneksin nr. 5 të Manualit për MFK, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 4 datë 26.01.2024.

-Mungojnë procesverbalet e minutave të takimit të mbledhjeve të GMS-së ku dokumentohen diskutimet, analizat dhe vendimmarrjet lidhur me realizimin e detyrave të këtij grupi. Janë vendosur në dispozicion të grupit vetëm 2 procesverbale të GMS për vitin 2025.

- DBNJBK nuk ka hartuar plane vjetore trajnimesh të detyrueshme për punonjësit e saj, përveç korrespondencës me ASPA.

1.2. Referuar komponentit “Menaxhimi i Riskut” nga auditimi u konstatua se:

- Titullari i AK-së nuk ka nxjerrë një urdhër për ngritjen e Grupit të Menaxhimit të Riskut (GMR), në kundërshtim me kërkesat e Manualit të MFK, miratuar me Urdhër nr. 4, datë 26.01.2024, Kapitulli III, pika 3.2.

- Regjistri i Riskut nuk përmban risqe për të gjitha drejtoritë e institucionit si dhe nuk janë hartuar plane të masave për menaxhimin e risqeve, në mospërputhje me kërkesat e anekseve 4, 5, 6 dhe 7 të Manualit të MFK.

1.3. Referuar komponentit “Aktivitetet e Kontrollit” nga auditimi u konstatua se:

- AK nuk ka përditësuar gjurmët e auditimit në mënyrë të vazhdueshme, për të siguruar pasqyrimin e qartë të ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban çdo proces, në kundërshtim me kërkesat e Aneksit nr. 3 të Manualit të MFK.

- AK nuk ka procedurë specifike për ruajtjen nga përdorimi i paautorizuar i aktiveve të rëndësishme (me vlera të konsiderueshme).

- AK për periudhën objekt auditimi nuk ka operuar me ndonjë sistem financiar të mbajtjes së të dhënave, por vetëm me paketën e microsoft/programin excel, i cili është lehtësisht i modifikueshëm dhe nuk i ruan të dhënat financiare institucionale në formë elektronike, jo në përputhje me pikën 2.4.5, pika g, të Urdhrit nr. 4, datë 26.01.2024 të MF. Gjithashtu u evidentua se pjesa më e madhe e të dhënave/analizave mbahen në format Excel dhe u evidentuan evidenca jo të plota dhe jo kronologjike të vendimeve me gjoba të Komisionit të Konkurrencës dhe ekzekutimeve të tyre.

- Në AK mungojnë manualet e punës për proceset kyçe, të cilat do të garantonin uniformitetin në kryerjen e aktiviteteve, identifikimin e qartë të detyrave, përgjegjësi dhe afateve për realizimin e tyre.

1.4. Referuar komponentit “Monitorimi” nga auditimi u konstatua se:

- Nuk është miratuar një Plan Veprimi i MFK për ndjekjen e progresit në arritjen e objektivave dhe për analizën e shkaqeve të dështimeve të mundshme në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Manualit të MFK-së.

-AK nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për monitorimin e zbatimit të Planit të Kontrollit të Brendshëm, në kundërshtim me Manualin e MFK-së.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 24-34 të Raportit të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Titullari i Autoritetit të Konkurrencës, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të institucionit, të marrë masa për forcimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, përmes:

- ndryshimin e rregullores së brendshme të institucionit në koherencë me ndryshimet strukturore;
- sigurimit të funksionit të auditimit të brendshëm dhe plotësimit të nevojave për burime njerëzore;
- ngritjes dhe funksionalizimit të mekanizmave të menaxhimit të riskut, përfshirë Grupin e Menaxhimit të Riskut, regjistrin gjithëpërfshirës të riskut dhe planet përkatëse të menaxhimit të tij;
- hartimit dhe monitorimit të dokumenteve kryesore të MFK-së, përfshirë Planin e Veprimit, Planin e Kontrollit të Brendshëm dhe dokumentacionin për gjurmën e auditimit;
- standardizimit dhe dokumentimit të proceseve të punës, hartave të proceseve dhe manualeve përkatëse;
- forcimit të kontroleve për mbrojtjen e aktiveve dhe ruajtjen e gjurmës së auditimit në proceset vendimmarrëse;
- identifikimit të nevojave për trajnim dhe zhvillimit profesional të stafit;
- unifikimit dhe konsolidimit të evidencave administrative dhe operative të mbajtura në format elektronik.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” për periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2023, rezultoi se janë lënë gjithsej 17 rekomandime. Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr. 506/9 Prot. datë 19.11.2024 në Autoritetin e Konkurrencës rezultoi nga 17 rekomandime (Masa organizative, Masa për shpërblim dëmi, Masa Disiplinore), janë pranuar nga subjekti 17 rekomandime ose 100 %. Nga të cilat: janë zbatuar plotësisht 10 rekomandime, ose 58 % e tyre, është në proces zbatimi 1 rekomandim ose 5.8 % , janë zbatuar pjesërisht 4 rekomandime ose 23.5 % dhe janë të pazbatuara 2 rekomandime ose 11.7 %.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2. 4, faqe 34-46 të Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Strukturat Drejtuese të AK-së, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshëm, si dhe të marrë masat e nevojshme për zbatimin e masave pjesërisht të realizuara, të pa zbatuara dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së Institucionit, konkretisht Masat Organizative si vijon:

1.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Titullari i Autoritetit të Konkurrencës për organizimin dhe dokumentimin e aktivitetit periodik të Grupit të Menaxhimit Strategjik lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

4.1 Rekomandimi: Të merren masa për të ndërtuar dhe përditësuar regjistrin e aktiveve në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër, grupit përkatës brenda llojit, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

5.1 Rekomandimi: Nga strukturat drejtuese të AK-së të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, duhet të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, duke e

dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

6.1 Rekomandimi: Autoriteti i Konkurrencës të vlerësojë dhe të analizojë vlerën prej 3,196,058 lekë propozuar për tu nxjerrë nga përdorimi, e cila rezulton pa dokumentacion justifikues ku të përcaktohen shkaqet, arsyet, përgjegjësitë ligjore dhe financiare.

-Të analizohen rezultatet e grupeve të inventarizimit për të formalizuar procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; listën e aktiveve të identifikuara dhe kriteret për vlerësim, procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve në referencë UMF Nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

-Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve për nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës të detajuar mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

7.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i AK që në të ardhmen kriteret e veçanta për kualifikim të jenë në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me objektin që prokurohet. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë.

-Procedurat e prokurimit “Blerje karburanti” të cilat bazohen në ofertën ekonomikisht më të favorshme, çmimi të përlogarit bazuar në kriteret e përcaktuara në VKM Nr.258, datë 19.05.2021, neni 45 i ndryshuar.

-Hartimi i dokumentacionit paraprak për fillimin e procedurës së prokurimit me sistem dinamik blerje bileta avioni të përgatitet nga momenti i ardhjes së ftesës për pjesëmarrje në event, me qëllim minimizimin e riskut për rritjen e kostos së blerjes së biletave me çmim më të lartë.

10.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Autoriteti i Konkurrencës që në të ardhmen në procedurat e prokurimit të llojit “Tender i Hapur i Thjeshtuar”, të merren në konsideratë kriteret të thjeshtuara pranimit në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim.

11.1 Rekomandimi: Autoriteti i Konkurrencës të marrë masa për të siguruar realizimin e shërbimit të auditimit me një njësi Auditimi të Brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje mes titullarëve të institucionit me qëllim përmbushjen e kërkesave të Ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar dhe VKM Nr.83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

Brenda 6-muajve

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, gërma (b) dhe (c), si dhe mbështetur në Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102, Titullari i Njesisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, me qëllim kërkimin dhe shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit **në vlerën 2,938,241 lekë** sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të trajtuara më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i buxhetit dhe urdhërpagesave u konstatua se nga Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 731 datë 18.08.2025 është kërkuar rikthimi i shumave të arkëtuara

për gjobat e vendosura dhe arkëtuara në vitet e mëparshme, të cilat sipas vendimit nr. 127 datë 30.01.2025 të Gjykatës Administrative të Apelit kanë lënë në fuqi Vendimin nr. 1584 datë 15.06.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë për shfuqizimin e Vendimit nr. 874 datë 25.03.2022 të Autoritetit të Konkurrencës. Sipas kësaj kërkesë, detyrimet për t'ju kthyer subjekteve paraqiten në shumën 7,087,994 lekë për subjektin “Ç.” ShPK dhe në shumën 8,693,597 lekë për subjektin “M.” shpk. Nga auditimi u konstatua se kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Këto detyrime janë paguar me urdhër shpenzimet:

- nr. 264 datë 31.12.2025 në shumën 7,087,994 lekë për subjektin “Ç.” shpk, me dokumentacion bashkëngjitur, kërkesën e subjektit “Ç.” shpk nr. 613 datë 23.06.2025, Urdhër nr. 1152 datë 31.12.2025 dhe vendimet e gjykatave.

- nr. 265 datë 31.12.2025 në shumën 8,693,597 lekë për subjektin “M.” shpk me dokumentacion bashkëngjitur lajmërim për ekzekutim vullnetar të përmbaruesit gjyqësor privat E. O. (ku citohet kthimi i shumës prej 8,693,597 lekë), Urdhër nr. 1152 datë 31.12.2025 dhe vendimet e gjykatave. Nga analiza e ekzekutimit të vendimeve me gjobë të AK u konstatua se nga subjekti “Ç.” shpk është ekzekutuar plotësisht detyrimi në shumën 7,087,994 lekë, ndërsa nga subjekti “M.” shpk është ekzekutuar pjesërisht në shumën 5,571,497 lekë nga vlera totale e detyrimit në shumën 66,088,573 lekë sipas vendimit nr. 874 datë 25.03.2022 të AK. Përsa më sipër u konstatua se ndryshojnë vlerat e arkëtuara nga vlerat e rikthyera drejt përmbaruesit sa i përket subjektit M., pasi nga 5,571,497 lekë të arkëtuara në vite, janë rikthyer 8,693,597 lekë ose një diferencë prej 3,122,100 lekë. Nga AK është vendosur në dispozicion shkresa nr. 542/4 datë 30.10.2025 të përmbaruesit drejtuar AK ku citohet se *“ekzekutimi është kryer në vlerën prej 8,693,597 lekë, nga të cilat 3,172,252 lekë tarifa e shërbimit përmbarimor”*. Nga auditimi i praktikës së pagesës u konstatua se bashkëngjitur nuk ka faturë për shërbimin përmbarimor që të justifikojë kryerjen e pagesës në këtë shumë. Ekzekutimi nga përmbaruesi është kryer vetëm për detyrimin pjesor në shumën 5,571,497 lekë dhe jo për shumën e plotë të detyrimit në shumën 66,088,573 lekë. Tarifa përmbarimore e aplikueshme për shumën 5,571,497 lekë duhet të ishte llogaritur në shumën 183,859 lekë me tvsh. (2.75% e shumës së ekzekutuar sipas udhëzimit nr. 385/7 datë 28.06.2017 *“Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi gjyqësor privat”*, i ndryshuar). Pagesa është kryer në mënyrë të padrejtë për diferencën në shumën 2,938,241 lekë (3,122,100 lekë – 183,859 lekë) si pasojë e kësaj tarife ndërkohë që në rastin e detyrimit të shoqërisë “Ç.” shpk ekzekutimi është kryer vullnetarisht me kërkesë të saj. Gjithashtu nga auditimi u konstatua se mungon Urdhri i Titullarit për kryerjen e pagesës së vendimit gjyqësor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 60 të Udhëzimit Standard të Zbatimit të Buxhetit nr. 9 datë 20.03.2018, i ndryshuar. Kryerja e pagesës më tepër nga AK është në kundërshtim me Udhëzimin e përbashkët të MF dhe MD nr. 385/7 datë 28.06.2017 *“Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat”*, i ndryshuar, pika 7 dhe pika 9.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 10-20 të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Autoritetit të Konkurrencës të merren të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej 2,938,241 lekë, ndaj përmbaruesit gjyqësor privat E. O., si pagesë e kryer tepër referuar aplikimit jo proporcional të tarifës përmbarimore mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar. Në të njëjtën kohë të përcillet rasti për masa administrative përkatëse sipas legjislacionit të fushës në Ministrinë e Drejtësisë.

Menjeherë

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 24.11.2014 *“Për organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, germet “b”, “c” dhe “ç” të nenit 58 *“Llojet e masave disiplinore”*, të ligjit nr. 153/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”* i rekomandohet Titullarit të Autoritetit të Konkurrencës vlerësimi i problematikave dhe shkeljeve të përshkruara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi dhe dhënia e masave disiplinore për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.